



QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VLADA REPUBLIKE KOSOVA
GOVERNMENT OF REPUBLIC OF KOSOVA

Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

PAVARËSI ENERGJETIKE PËR KOSOVËN

Kosova e Re *powerplant*

Pavarësi Energjetike për Kosovën



mzhe-ks.net

PËRMBAJTJA

A. PYETJET PËR POLITIKAT ENERGJETIKE NË KOSOVË8

1. SI PLANIFIKON KOSOVA TË PËRMBUSH NEVOJËN E SAJ PËR ENERGJI NË TË ARDHMEN?8
2. CILAT JANË RESURSET NË DISPOZICION PËR PRODHIMIN E ENERGJISË NË KOSOVË?9
3. PSE I DUHET KOSOVËS NJË TERMOCENTRAL ME DJEGIE TË LINJITIT?9
4. ÇFARË PO BËN KOSOVA PËR TË KRIJUAR MË SHUMË KAPACITETE PRODHUESE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË? 10
5. A E PENGON TERMOCENTRALI ME DJEGIE TË THËNGJILLIT ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE TË TJERA TË PRODHIMIT BAZUAR NË BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË? 11
6. A KEMI NEVOJË PËR NJË TERMOCENTRAL ME DJEGIE TË THËNGJILLIT NËSE ZHVILLOJMË TË GJITHA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË, RIPAROJMË TERMOCENTRALET EKZISTUES ME DJEGIE TË LINJITIT DHE ZBATOJMË MASA TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË?..... 12
7. A MUND T’I PENGOJË TERMOCENTRALI I RI ME DJEGIE TË THËNGJILLIT PËRPJEKJET E KOSOVËS PËR T’U BËRË PJESË E BASHKIMIT EVROPIAN?..... 12
8. KUSH PO E MBËSHTET NDËRTIMIN E TERMOCENTRALIT TË RI ME DJEGIE TË THËNGJILLIT NË KOSOVË? 12
9. PSE KOSOVA MBËSHTETET NË SEKTORIN PRIVAT PËR TË NDËRTUAR TERMOCENTRALIN E RI, NË VEND QË SHTETI TA NDËRTOJË ATË VET? 13

B. PROJEKTI I TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE 14

10. ÇKA NË TË VËRTETË ËSHTË PROJEKTI KOSOVA E RE? 14
11. CILËT JANË KOMPONENTËT KRYESORË TË PROJEKTIT?..... 14
12. KUSH E MBIKËQYR PROJEKTIN? 14
13. SI ËSHTË DUKE E PËRFSHIRË QEVERIA E KOSOVËS SEKTORIN PRIVAT NË ZHVILLIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE? 15
14. KUSH ËSHTË PARTNERI PRIVAT QË DO TË NDËRTOJË TERMOCENTRALIN?..... 15
15. CILAT JANË AFATET KOHORE TË PROJEKTIT DHE CILAT JANË ZHVILLIMET E ARDHSHE KRYESORE?..... 16
16. CILAT JANË MARRËVESHJET KONTRAKTUESE TË PROJEKTIT?..... 16
17. KUSH DO TË SIGUROJË LINJITIN PËR TERMOCENTRALIN E RI? 17
18. ÇFARË GARANCISH ËSHTË DUKE I DHËNË QEVERIA E KOSOVËS PARTNERIT PRIVAT, DHE A KËRKOJNË KËTO GARANCI APROVIM NGA PARLAMENTI? 18
19. KUSH DO TË FINANCOJË NDËRTIMIN E TERMOCENTRALIT? 18
20. KUSH DO TA NDËRTOJË TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?..... 19
21. KUSH DO TA KETË NË PRONËSI TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?..... 19
22. KUSH DO TË OPEROJË ME TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?..... 19
23. KUR DO TË FILLOJË NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT TË RI DHE SA DO TË ZGJAS AI? 20

24. KUSH DO TË MBIKËQYR NDËRTIMIN DHE PRANIMIN E TERMOCENTRALIT?	20
25. KUR MUND TË PRESIM FURNIZIMIN E ENERGJISË SË PARË ELEKTRIKE?.....	20

C. FAKTET E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE (TCKR)..... 21

26. KUSH DO TA KETË NË PRONËSI TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?.....	21
27. ÇFARË TEKNOLOGJIE DO TË APLIKOHET NË TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?	21
28. EFIÇIENCA E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE.....	21
29. SA ENERGJI ELEKTRIKE DO TË PRODHOJË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE?.....	22
30. SA LINJIT DO TË KONSUMOJË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE DHE SA ËSHTË KJO KRAHASUAR ME TERMOCENTRALET EKZISTUESE NË KOSOVË?.....	22
31. SA UJË DO TË KONSUMOJË KOSOVA E RE DHE A KA UJË TË MJAFTUESHËM PËR KËTË TERMOCENTRAL?	23

D. NDIKIMET MJEDISORE TË KOSOVËS SË RE 24

32. CILAT JANË STANDARDET MJEDISORE TË NDJEKURA PËR DIZAJNIMIN DHE OPERIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?.....	24
33. SI ËSHTË PËRZGJEDHUR LOKACIONI PËR NDËRTIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?	24
34. SI JANË VLERËSUAR NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE PËR KËTË PROJEKT?	25
35. CILAT JANË NDIKIMET E PARASHIKUARA MJEDISORE DHE SOCIALE GJATË NDËRTIMIT TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?.....	26
36. CILAT JANË NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE GJATË OPERIMIT TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?	26
37. ÇFARË LLOJE TË MBETJEVE DHE EMETIMEVE DO TË PRODHOHEN GJATË OPERIMIT TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?.....	28
38. SA CO ₂ DO TË EMETOJË TC KOSOVA E RE?.....	28
39. KU DO TË DEPOZITOHEN HIRI DHE NËN-PRODUKTET E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?	28
40. KUSH DO TË JETË PËRGJEGJËS PËR DEKOMISIONIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE PASI TË ARRIJË FUNDIN E JETËS OPERACIONALE KOMERCIALE?	29
41. KUSH NË KOSOVË MUND TË SIGUROJË QË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE I PËRMBUSHË STANDARDET E PERFORMANCËS MJEDISORE?	29

E. NDIKIMI EKONOMIK 31

42. SI DO TË NDIKOJË NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE NË QËNDRUESHMËRINË E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NË KOSOVË?	31
43. A DO TË KRIJOJË MUNDËSI TË REJA PUNËSIMI NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?	31
44. SI MUND TË PËRFITOJË KOMUNITETI I PREKUR NGA FONDI PËR ZHVILLIMIT TË KOMUNITETIT?	32
45. SI DO TË PËRFITTOJ EKONOMIA E KOSOVËS NGA TERMOCENTRALI KOSOVA E RE?.....	32

46. A DO MUND TË PËRBALLOJNË KONSUMATORËT E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË ENERGJINË NGA TERMOCENTRALI KOSOVA E RE?	33
47. A E PENGOJNË NDËRTIMI DHE MARRËVESHJET KONTRAKTUESE TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS?	34
48. SI DO TË NDIKOJË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE NË TREGUN E PËRBASHKËT KOSOVË-SHQIPËRI?	34

LISTA E SHKURTESAVE

BAT - Teknikat më të Mira në Dispozicion (Best Available Techniques)

BRE – Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

BREF - Dokumentet Referuese të Teknikave më të Mira në Dispozicion
(Best Available Techniques Reference Documents)

CCR - I gatshëm për kapje të karbonit (Carbon Capture Ready)

CFBC – Kaldaja me shtrat qarkullues të lëngëzuar (Circulating Fluidized Bed Combustion)

CG – ContourGlobal, partneri privat në projektin e TCKR

ECA – Agjencitë e Kreditimit të Eksportit (Export Credit Agency)

EOI – Shprehje e Interesit (Expression of Interest)

EPC – Inxhiniering-Prokurim-Ndërtim (Engineering–Procurement–Construction)

ERO – Zyra e Rregullatorit për Energji (Energy Regulatory Office)

GENCO – Kompania e Gjenerimit (Generation Company)

IED – Direktiva për Emetimet Industriale (Industrial Emissions Directive)

IFI – Institucionet Ndërkombëtare për Financim (International Financing Institutions)

IRR – Normën e Brendshme fikse e Kthimit të Kapitalit (Internal Rate of Return)

KEK – Korporata Energjetike e Kosovës

KESCO – Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (Kosovo Energy Supply Company)

KDP – Komiteti Drejtues i Projektit (Project Steering Committee)

KOSTT – Operator Sistemi, Transmisioni, dhe Tregu (Transmission, System and Market Operator)

LCPD – Direktiva për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme (Large Combustion Plants Directive)

LSA – Marrëveshja për furnizim me linjit (Lignite Supply Agreement)

LTM – Mirëmbajtje Afat-Gjatë (Long Term Maintenance)

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

MW – Megavat

MWH – Megavat orë

MWTH – Megavat termik

KREK – Korporatës së Re Energjetike të Kosovës

PCC – Kaldaja me djegie të pluhurizuar të linjtit (Pulverized Coal Combustion)

PIU – Njësia Implementuese e Projektit (Project Implementation Unit)

PPA – Marrëveshja për Blerjen e Energjisë (Power Purchase Agreement)

PPP – Partneritet Publiko Privat

QK – Qeveria e Kosovës

O&M – Operimi dhe Mirëmbajtja

TCKR – Termocentrali Kosova e Re

PV – Fotovoltaike (Photovoltaic)

RFP – Kërkesa për Propozime (Request for Proposals)

VNMS – Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social

PYETJET MË TË SHPESHTA

A. PYETJET PËR POLITIKAT ENERGJETIKE NË KOSOVË

1. SI PLANIFIKON KOSOVA TË PËRMBUSH NEVOJËN E SAJ PËR ENERGJI NË TË ARDHMEN?

Sigurimi i një furnizimi të qëndrueshëm, cilësor, të sigurt dhe të besueshëm me energji është një ndër kushtet kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të çdo vendi. Ky problem është bërë akut në Kosovë dhe kërkon një zgjidhje urgjente, edhe pse çdo zgjidhje do të kërkojë investim substancial në këtë sektor.

Një sfidë me të cilën përballlet sektori i energjisë në Kosovë është nevoja për progres në tri fronte në të njëjtën kohë: intervenimi për rehabilitimin e kapaciteteve ekzistuese; ndërtimi i kapaciteteve të reja (përfshirë BRE) për zëvendësimin e termocentraleve të vjetruara; dhe investimet në zhvillimin e minierës së re të linjitet. Një aktivitet i tillë do të kërkojë një investim të njëkohshëm prej 2 - 3 miliardë Euro gjatë 10 viteve të ardhshme.

Strategjia e Energjisë së Kosovës 2017-2026 e miratuar së fundmi përcakton objektivat themelore të Qeverisë së Kosovës në zhvillimin e sektorit të energjisë, duke marrë parasysh zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, furnizimin e qëndrueshëm dhe të besueshëm me energji për konsumatorët, përdorimin efikas të energjisë, zhvillimin e kapaciteteve të reja prodhuese konvencionale dhe të ripërtëritshme, krijimin e një tregu konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit dhe krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin energjetik.

Strategjia e Energjisë rekomandon disa masa për të përmbushur këto pesë objektiva strategjike:

1. Siguria e furnizimit të qëndrueshëm, cilësor, të sigurt dhe të besueshëm me energji me kapacitete adekuate për funksionimin stabil të sistemit të energjisë.
2. Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë;
3. Përmirësimi i kapacitetit të sistemit ekzistues termal (ngrohjes së hapësirës) dhe ndërtimi i kapacitetit të ri energjetik;
4. Zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror; dhe
5. Arritja e synimeve dhe objektivave në efikasitetin e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe mbrojtjen e mjedisit.

Masat kryesore për të arritur Objektivin I përshijnë:

- Ndërtimi i Termocentralit të ri Kosova e Re (TCKR) në përputhje me kriteret mjedisore të përcaktuara në Direktivën e Emetimeve Industriale (IED) dhe mundësisë për përdorimin e kogjenerimit prej së paku 10% të kapacitetit të tij neto.
- Vazhdimi i funksionimit të TC Kosova A deri në zëvendësimin e saj nga Termocentrali Kosova e Re.
- Përfundimi i rehabilitimit të TC Kosova B për respektimin e kriterëve mjedisore dhe vazhdimin e jetës së tij funksionale deri me 2040.
- Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me linjit përmes zhvillimit të minierës së re.
- Mbështetja e vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve të reja të BRE-së.
- Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Zhvillimi i një programi për mbrojtjen e konsumatorëve në gjendje të vështirë ekonomike.
- Zbatimi i praktikave më të mira për trajtimin e komuniteteve të prekura nga aktivitetet e energjisë elektrike.

2. CILAT JANË RESURSET NË DISPOZICION PËR PRODHIMIN E ENERGJISË NË KOSOVË?

Është i njohur botërisht fakti se Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit (vendi i tretë në Europë me rezervat më të mëdha pas Gjermanisë dhe Polonisë). Linjiti ishte dhe mbetet burimi dominues i lëndës djegëse për prodhimin e energjisë në Kosovë, duke furnizuar termocentralet ekzistuese dhe akoma funksionale TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Roli i ardhshëm i linjtit në Kosovë lidhet drejtpërdrejt me vazhdimin e funksionimit të TC Kosova B deri në vitin 2040 dhe me ndërtimin dhe funksionimin e termocentralit të ri me djegie të linjtit Kosova e Re (500 MW) për 40 vitet e ardhshme.

Prodhimi aktual i minierës sillet rreth 8 milionë tonë linjit në vit. Ky nivel i prodhimit do të mbetet kështu deri në vitin 2040 dhe me largimin e TC Kosova B nga prodhimi, kapaciteti i minierës do të bie në 4.0 milionë t/vit.

Pa plane të reja për ndërtimin e termocentraleve të reja me djegie të linjtit (pas Termocentralit Kosova e Re), roli i linjtit në përzjerjen e energjisë së Kosovës do të humb rëndësinë dhe kapacitetet e reja prodhuese duhet të bazohen ekskluzivisht në Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE).

Shfrytëzimi i BREve në prodhimin e energjisë paraqet synim afatgjatë për realizimin e tri arritjeve kryesore të politikave të energjisë: mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik; rritjen e sigurisë së furnizimit me energji; dhe mbrojtjen e mjedisit.

Potenciali i vërtetë i BRE-ve në Kosovë nuk është vlerësuar plotësisht dhe potencialet që tashmë dihen vazhdojnë të mos jenë të shfrytëzuara sa duhet. BRE-të kryesore në Kosovë janë potenciali modest për hidroenergji (hidrocentrale të vogla), energjia e erës në margjinën e ulët të shpejtësisë së erës, potenciali për energji fotovoltaike (PV) dhe resurset shumë të kufizuara të biomasës.

Shfrytëzimi i potencialit të erës dhe atij fotovoltaike, po ashtu ndërlidhet me progresin e vazhdueshëm teknologjik global në futjen në përdorim të këtij potenciali, me përmirësime në turbinat me nivel të ulët të shpejtësisë së erës, rritjen e efikasitetit të paneleve PV, kosto më të ulëta të instalimit dhe kombinimi i burimeve BRE me opsionet për ruajtjen e energjisë. Me këto përparime teknologjike, shpresohet se potenciali i vërtetë në dispozicion i BRE-ve në Kosovë do të shfrytëzohet në nivelin maksimal.

3. PSE I DUHET KOSOVËS NJË TERMOCENTRAL ME DJEGIE TË LINJITIT?

Edhe pse Kosova ka rezerva të mëdha të linjtit, prej vitit 1984 nuk ka pasur asnjë investim në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese ose rehabilitim substancial të termocentraleve ekzistuese, si rezultat i të cilës Kosovës tani i mungon furnizimi stabil me energji. Për më tepër, teknologjia e prodhimit të energjisë e termocentraleve ekzistuese nuk i plotëson kriteret mjedisore të përcaktuara në legjislacionin e BE-së. TC Kosova A dhe TC Kosova B së bashku kanë kapacitet prej 1478 MW, por për shkak të vjetërsisë së tyre, kapaciteti i tyre operacional është rreth 915 MW, ose 62%e kapacitetit të përgjithshëm të instaluar. Kapaciteti ekzistues i prodhimit është i vjetruar, ka nevojë për riparime të vazhdueshme dhe funksionon me teknologji joefikase. Situata në minierat e linjtit po ashtu nuk është mirë, ku pajisjet e vjetruara të mihjes duhet të zëvendësohen dhe ku ekzistojnë sfida lidhur me zbatimin e praktikave më të mira për trajtimin e komuniteteve të prekura nga këto operacione të mihjes.

Nga pikëpamja e prodhimit dhe konsumit vjetor, Kosova është importues neto i energjisë. Si rrjedhojë, ajo përballet me probleme të mëdha për sigurimin e sasive të nevojshme të energjisë për të mbuluar kërkesat më të larta, veçanërisht në dimër, dhe në plotësimin e kërkesave për kapacitete rezervë të sistemit të energjisë.

Për të ofruar siguri në furnizimin me energji elektrike, Kosova duhet të zëvendësojë TC Kosova A me një kapacitet të ri prodhues. Në përgatitjen e projektit të Termocentralit Kosova e Re (TCKR), Qeveria i ka marrë parasysh me kujdes edhe faktorët mjedisorë edhe ata të kostos. Në fakt, për të siguruar financim nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFI) për një termocentral me djegie të linjtit, janë marrë parasysh plotësisht të gjitha alternativat e realizueshme dhe kostot e tyre ekonomike, krahasuar me alternativën me djegie të linjtit. Një studim i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është hartuar në vitin 2014 (i cili është duke u rishikuar dhe rishikimi pritet të përfundojë deri në maj 2018) për të konsoliduar

rezultatet e disa studimeve të mëhershme të sponzoruara nga Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe donatorët e tjerë, dhe për të përcaktuar opsionin me koston më të ulët që do t'i mundësonte Kosovës të plotësojë nevojat e saj për furnizim dhe siguri të energjisë. Ky studim nuk analizon vetëm koston e alternativave që janë në dispozicion që Kosova të përmbushë kërkesat për konsum të energjisë dhe për kohën kur kërkesa është më e lartë deri në vitin 2025, por e ka marrë parasysh edhe koston e aspekteve të jashtme mjedisore të lidhura me secilin opsion. Në mënyrë specifike, ky studim nuk adreson vetëm opsionet e lëndës djegëse termike, por secilën prej zgjidhjeve të energjisë alternative në dispozicion, përfshirë edhe BRE-në.

Studimi i VNMS (2014) ka arritur në përfundim se Termocentrali Kosova e Re është opsioni me koston më të ulët për të arritur këto qëllime.

Rrjedhimisht, duke marrë parasysh edhe faktorët mjedisorë dhe faktorët e koston, Qeveria u përcaktua për Termocentralin Kosova e Re si zgjidhje e duhur për periudhën afatgjatë, duke mundësuar përmirësimin e furnizimit me energji dhe duke mundësuar kalimin më të sigurt energjetik nga energjia që varet nga linjiti drejt Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.

Qëllimi i TCKR-së së propozuar është të sigurojë burim afatgjatë dhe të sigurt të energjisë elektrike për të mbështetur rritjen dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Prodhimi nga ky termocentral do të zëvendësojë atë të Kosovës A dhe do të ndihmojë që të mbulohet rritja e kërkesës si dhe do të zvogëlojë nevojën për importim të energjisë. Termocentrali i ri po ashtu do të reduktojë emetimin në atmosferë krahasuar me atë të termocentraleve ekzistuese, Kosova B e veçanërisht Kosova A, pasi që do të aplikohen Teknikat më të Mira në Dispozicion (BAT) në përputhje me Direktiva për Emetime Industriale (DEI) të BE-së. TCKR i propozuar do të dizajnohet në pajtim me parimet dhe rekomandimet që rezultojnë nga udhëzimet e BE-së për aplikimin e BAT-së për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.

4. ÇFARË PO BËN KOSOVA PËR TË KRIJUAR MË SHUMË KAPACITETE PRODHUESE NGA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERJISË?

Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) paraqesin një burim të rëndësishëm të energjisë në Kosovë. Shfrytëzimi i BRE në prodhimin e energjisë paraqet një synim afatgjatë për realizimin e tri arritjeve kryesore të politikave të energjisë: mbështetjen e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik; rritjen e sigurisë së furnizimit me energji; dhe përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit.

Për të inkurajuar shfrytëzimin e BRE-ve, Kosova ka zbatuar një skemë të mbështetjes e cila bazohet në tarifa nxitëse për energji të ujit, energji të erës, energji fotovoltaike dhe biomasë.

Ligjet e sektorit të energjisë, veçanërisht Ligji për Energjinë, synojnë të optimizojnë shfrytëzimin e BRE-ve, përfshirë edhe përcaktimin e synimeve vjetore dhe afatgjate për prodhimin e energjisë nga BRE dhe lehtësimin e qasjes së tyre në treg. Për të promovuar shfrytëzimin e BRE-ve, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) ka hartuar një Plan dhjetëvjeçar të Veprimit për to. Si anëtare e Komunitetit të Energjisë, Kosova është e obliguar të arrijë synimet e obligueshme për BRE 2020, siç janë përcaktuar dhe aprovuar nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë në vitin 2012. Për Kosovën, këto synime supozojnë se BRE paraqesin 25% të konsumit final bruto të energjisë, dhe këto synime janë përcaktuar në Planin Kombëtar të Veprimit. Udhëzimi Administrativ i MZHE-së i vitit 2013 kishte përcaktuar një synim prej 29.47% dhe një synim edhe më i lartë prej 29.89% ishte caktuar me Udhëzimin Administrativ të MZHE-së në vitin 2017. Përqindja aktuale e BRE-së në konsumin përfundimtar bruto në Kosovë në vitin 2015 ishte 19.7%.

Operatori i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu (KOSTT) luan një rol të rëndësishëm në promovimin e BRE-ve. Ai është i mandatuar me ligj për t'i dhënë prioritet prodhimit nga BRE-të, në përputhje me kufijtë e specifikuar në Kodin e Rrjetit. Një stimulim tjetër shtesë për BRE-të qëndron në obligimin ligjor të Operatorit të Tregut që të blejë prodhimin e BRE-ve me tarifën nxitëse të rregulluar, siç është përcaktuar nga ZRRE. Aktualisht, tarifën nxitëse ndryshojnë sipas teknologjive të ndryshme të BRE-ve, si vijon:

- për hidrocentrale të vogla: 67.3 EUR/MWh (skemë e mbështetjes 10-vjeçare)
- centralet e erës: 85 EUR/MWh (skemë e mbështetjes 12-vjeçare)
- centralet e biomasës: 71,3 EUR/MWh (skemë e mbështetjes 10-vjeçare)
- fotovoltaike: 136,4 EUR/MWh (skemë e mbështetjes 12-vjeçare)

Deri në fund të vitit 2017, përafërsisht 62 projekte të BRE-së kanë aplikuar për Autorizim nga ZRRE. Tabela më poshtë paraqet statusin e projekteve të ndryshme.

	Hidro		Foto voltaike		Era		Biomasa	
	MW	Lokacionet	MW	Lokacionet	MW	Lokacionet	MW	Lokacionet
Është dhënë autorizimi përfundimtar dhe funksionon	31.2	5	0.602	2	1.35	1	0	0
Është dhënë autorizimi përfundimtar	61.9	16	9.4	4	32.4	1	0	0
Është dhënë autorizimi paraprak	28	14	0	0	105	3	0	0
Është dhënë autorizimi paraprak - në pritje	0	0	15.27	6	35	1	0	0
Duke u shqyrtuar aplikacionet	9.9	1	21	7	64.8	1	0	0
Gjithsejt	131	36	46.272	19	238.55	7	0	0

Statusi i projektit të BRE	Kapaciteti [MW]
Është dhënë autorizimi përfundimtar dhe në funksion	33.15
Është dhënë autorizimi përfundimtar	103.70
Është dhënë autorizimi paraprak	133.00
Është dhënë autorizimi paraprak - në pritje	50.27
Duke u shqyrtuar aplikacioni	95.70
Gjithsejt	415.82

Sot, përpjekjet e Kosovës për të zhvilluar kapacitetet e reja prodhuese janë pak a shumë të barabarta si për tlinjit ashtu edhe për BRE. Meqë roli i linjtit në përbërjen e ardhshme të energjisë së Kosovës do të bie (me heqjen nga prodhimi i TC Kosova B në vitin 2040 dhe pa plane për ndërtimin e termocentraleve të tjera shtesë me linjit pas Termocentralit Kosova e Re), roli i BRE gjithsesi që do të rritet, duke e vënë Kosovën në rrugë drejt transformimit rrënjësor të sektorit të energjisë. Përveç kësaj, politika e re e BE-së që bën thirrje që t’i jepet fund skemave të mbështetjes direkte do të kërkojë hartimin e politikave shtesë në Kosovë për mbështetjen e BRE-ve.

5. A E PENGON TERMOCENTRALI ME DJEGIE TË THËNGJILLIT ZHVILLIMIN E PROJEKTEVE TË TJERA TË PRODHIMIT BAZUAR NË BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË?

Kapaciteti fillestar i Termocentralit Kosova e Re ka qenë 2,100 MW; që prej atëherë ai është zvogëluar në vetëm 500 MW/ 450 MW neto. Ky kapacitet i Termocentralit Kosova e Re në asnjë mënyrë nuk do të pengojë zhvillimin e projekteve të BRE-ve. Për më tepër, projektet e BRE-ve që janë duke u zhvilluar aktualisht përfitojnë nga skema e mbështetjes së përcaktuar me ligj, tarifatat nxitëse, marrëveshjet afatgjate për blerje dhe trajtimi me prioritet.

Me kapacitetin e saj të kufizuar, misioni i Termocentralit Kosova e Re thjesht do t’i zëvendësojë njësitë e vjetruara prodhuese në TC Kosova A dhe do të rrisë sigurinë e furnizimit përmes aplikimit të energjisë së besueshme bazë (dhe energjisë termike për ngrohjen e hapësirës). Pa masa të duhura për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe integrimin në tregun rajonal të energjisë elektrike, Kosova rrezikon që të mbetet importues neto i energjisë elektrike për një kohë të gjatë.

Me mbylljen e TC Kosova B në vitin 2040, do të ketë shumë presion në BRE-të që të mbushin këtë boshllëk. Në këtë kontekst është me rëndësi të theksohet se Kosova ka potencial të kufizuar për hidroenergji, derisa era dhe ajo fotovoltaike ende konsiderohen si burime jo të përhershme që kërkojnë investime shtesë në forcimin e rrjetit të energjisë elektrike, duke siguruar rezerva në sistem dhe duke zhvilluar opsione për ruajtjen e energjisë. Sfidat kryesore për Kosovën do të jetë që të krijohen kushtet që do të inkurajojnë zhvillimin e sa më shumë që të jetë e mundur të BRE-ve, për të plotësuar boshllëkun në furnizim me koston më të ulët duke adresuar të gjitha çështjet mjedisore.

6. A KEMI NEVOJË PËR NJË TERMOCENTRAL ME DJEGIE TË THËNGJILLIT NËSE ZHVILLOJMË TË GJITHA BURIMET E RIPËRTËRITSHME TË ENERGJISË, RIPAROJMË TERMOCENTRALET EKZISTUES ME DJEGIE TË LINJITIT DHE ZBATOJMË MASA TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË?

Po, kemi nevojë. Zhvillimi i potencialit të BRE-ve në Kosovë dhe zbatimi i masave efektive për efikasitetin e energjisë do të marrin kohë. Kosova po ashtu është nën presion që ta mbyll menjëherë termocentralin shumë të vjetër Kosova A, i cili paraqet pothuaj gjysmën e kapacitetit prodhues të energjisë së vendit. Duhet të merret parasysh se shumica e potencialit të BRE-ve në Kosovë (diellorë dhe erës) përbëhet nga burimet e paqëndrueshme (intermitent) (që kërkojnë masa mbështetëse plotësuese për ta lehtësuar qasjen në treg. Duke marrë parasysh se shumica e vendeve në rajon janë importues neto dhe se çmimet e tregut të energjisë elektrike janë subjekt i kushteve të ndryshueshme hidrologjike, as mbështetja në importim nuk është zgjidhje e qëndrueshme për sigurinë energjetike në Kosovë dhe për zhvillimin ekonomik.

Termocentrali Kosova e Re (500 MW) është i nevojshëm për të garantuar sigurinë e furnizimit dhe për të blerë kohën e nevojshme për të bërë kalimin e lehtë tek burimet e energjisë nga BRE.

7. A MUND T'Ë PENGOJË TERMOCENTRALI I RI ME DJEGIE TË THËNGJILLIT PËR PJEKJET E KOSOVËS PËR T'U BËRË PJESË E BASHKIMIT EVROPIAN?

Shumica e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian kanë miratuar politika dhe udhërrëfyes për dekarbonizimin e sektorëve të tyre të energjisë. Vendet pa rezerva të thëngjillit dhe ato me potencial të madh të BRE-ve janë më agresive në zbatimin e transformimit të sektorit të energjisë duke aplikuar afate kohore ambicioze dhe skema atraktive të mbështetjes së BRE-ve. Përkundër kësaj dhe kryesisht për shkak të nevojës për sigurinë e furnizimit, në Europë si tërësi, ende ka termocentralet e reja të linjtit që aktualisht janë duke u ndërtuar, ose në procesin e lëshimit në funksion dhe ka mbi 50 termocentralet e reja që aktualisht janë në fazën e planifikimit. Linjiti vazhdon të zë një pjesë të rëndësishme në sektorin energjetik në vendet evropiane që kanë rezerva të linjtit, siç janë Gjermania, Polonia, Republika Çeke, Greqia, Bullgaria dhe Sllovenia.

Të gjitha termocentralet e reja të linjtit të ndërtuara në shtetet anëtare të BE-së, si dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor që janë pjesë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, janë të obliguara ta respektojnë legjislacionin më të fundit mjedisor të BE-së, siç janë kufizimet gjithnjë e më të rrepta të emetimeve. Në rajonin tonë, rregulloret e tilla tashmë janë duke u aplikuar për termocentralet e reja që janë duke u ndërtuar në Slloveni, Bosnjë e Hercegovinë, Serbi dhe Mal të Zi. Të njëjtat rregullore do të aplikohen edhe për Termocentralin Kosova e Re.

Përderisa TC Kosova B rehabilitohet për të operuar në përputhje me këto kufizime të emetimeve, dhe Termocentrali Kosova e Re ndërtohet dhe operon në përputhje të plotë me direktivat e BE-së (ashtu siç kërkohet), atëherë termocentralet e Kosovës me linjit nuk do të shkaktojnë asnjë problem për anëtarësimin e ardhshëm të Kosovës në BE.

8. KUSH PO E MBËSHTET NDËRTIMIN E TERMOCENTRALIT TË RI ME DJEGIE TË THËNGJILLIT NË KOSOVË?

Gjatë dekadës së kaluar ka pasur një debat të nxehtë në Kosovë lidhur me ndërtimin e këtij termocentrali të ri me djegie të linjtit. Fillimisht fokusi i debatit ka qenë në kapacitetin e termocentralit (2,100 MW) për të plotësuar kërkesën e brendshme apo edhe për eksport (300 MW vetëm për kërkesën e brendshme); strukturën e projektit (miniera e linjtit dhe rehabilitimi i kapaciteteve prodhuese ekzistuese të përfshihen në pakon e tenderimit ose jo); dhe financimi i projektit (financimi privat kundrejt atij publik), si dhe procedurat për përfshirjen e sektorit privat.

Koncepti i ndërtimit të një termocentrali të ri me djegie të linjtit i bazuar në resurset vendore të linjtit aktualisht përkrahët në Kosovë nga i tërë spektri politik, akademik, komuniteti i biznesit dhe shumica e OJQ-ve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe organizatave dhe forumeve të ndryshme.

Me intensifikimin e debatit mbi ndryshimet klimatike viteve të fundit, kundërshtimet e reja bëjnë thirrje për anulimin e Termocentralit Kosova e Re, mbylljen e TC Kosova A, aplikimin e më shumë masave të efikasitetit të energjisë, shfrytëzimin më të madh të kapaciteteve të BRE-ve dhe një trajtim më të mirë të zhvillimit të minierës dhe çështjeve të ndërlidhura sociale. Shumë prej këtyre shqetësimeve tashmë janë adresuar në Strategjinë e Energjisë së Kosovës të miratuar kohëve të fundit.

Bazuar në gjetjet e studimeve të shumta të pavarura, TCKR vazhdon të jetë zgjidhja me koston më të ulët për të adresuar shqetësimet kritike për sigurinë e furnizimit me energji në Kosovë.

9. PSE KOSOVA MBËSHTETET NË SEKTORIN PRIVAT PËR TË NDËRTUAR TERMOCENTRALIN E RI, NË VEND QË SHTETI TA NDËRTOJË ATË VET?

Edhe pse qeveria pothuajse gjithmonë mund të marrë kredi apo të huazojë para me normë më të ulët të interesit se sa kompanitë private (kryesisht për shkak të kompetencave të saj tatimore), kompanitë private pothuajsegjithmonë mund të dizajnojnë, operojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën ose shërbimet në mënyrë më efikase se qeveria. Duke marrë parasysh se Kosova ka mungesë të konsiderueshme të infrastrukturës (që vlerësohet të jetë 10 miliardë euro) dhe resurse të kufizuara financiare, derisa në të njëjtën kohë ka interesim nga sektori privat që të përfshihet në projekte energjetike, Qeveria e Kosovës duhet të përdorë resurset e saja për të zhvilluar më tej efikasitetin në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe sektorë tjerë shoqërorë. Projekti i Termocentralit Kosova e Re konsiderohet projekt i Partneritetit Publiko Privat (PPP). Në PPP-të e strukturuar mirë, përfitimet shtesë që i sjellin kompanitë private zakonisht janë më të rëndësishme se kostoja më e lirë e financimit publik.

Në këtë projekt kontribuojnë të dyja palët, si sektori publik, po ashtu edhe ai privat me aspektet në të cilat ata janë më të mirët. Sektori publik kontribuon me lokacionin për ndërtimin e termocentralit të ri në mënyrë që të shfrytëzohen plotësisht faktorët që tashmë ekzistojnë, siç janë toka të cilën e ka në pronësi, shërbimet e rrjetit, infrastrukturën e furnizimit me linjit, furnizimin me ujë, infrastrukturën e transportit dhe të ngjashme, që të gjitha pastaj do të jenë në dispozicion për të mbështetur Termocentralin Kosova e Re. Qeveria, po ashtu merr përsipër rreziqet lidhur me furnizimin me linjit, furnizimin me ujë, për disa çështje mjedisore që lidhen me largimin e hirit dhe gjipsit në miniera, dhe garancitë për blerjen e energjisë. Sektori privat kontribuon me aftësitë e tij në menaxhimin efikas dhe me kosto efektive gjatë ndërtimit dhe operimit të impiantit dhe aftësitë e tij për sigurimin e financimit me kosto të leverdishme.

Projekti i Termocentralit Kosova e Re është i strukturuar ashtu që pala e sektorit privat do të jetë në gjendje t'i kthejë investimet e veta gjatë fazës së parë 20 vjeçare operationale të projektit, nëse u përmbahet standardeve të rrepta të performancës. Në këtë mënyrë, qeveria përfiton nga ofrimi më i mirë i shërbimeve, teknologjitë e reja dhe financimit inovativ të ofruar nga sektori privat.

Ndonëse ka shumë struktura të ndryshme në dispozicion për PPP, në rastin e Termocentralit Kosova e Re, sikurse edhe në rastin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, sektori privat do të operojë impiantin për 20 vjet, e pastaj ia transferon atë sektorit publik pa asnjë kosto në fund të periudhës së Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (MBE). Termocentrali Kosova e Re do të dizajnohet dhe ndërtohet për një jetëgjatësi operationale prej 40 vitesh, kështu që qeveria do të jetë në gjendje të operojë me termocentralin për periudhën e mbetur prej 20 vitesh. Gjatë kësaj periudhe, Termocentrali Kosova e Re do ta ketë shpërndarë koston e kapitalit, kështu që çmimi i ardhshëm i energjisë kryesisht do të bazohet në kostot operationale dhe të mirëmbajtjes.

B. PROJEKTI I TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE

10. ÇKA NË TË VËRTETË ËSHTË PROJEKTI KOSOVA E RE?

Qeveria e Kosovës e ka pranuar nevojën për kapacitete shtesë gjeneruese për të adresuar shqetësimet e vazhdueshme për sigurinë e furnizimit me energji në Kosovë dhe si çështje e politikave të saj ka vendosur ta përfshijë sektorin privat në një projekt të infrastrukturës për zhvillimin, dizajnimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, operimin dhe mirëmbajtjen e Termocentralit Kosova e Re. Projekti i Termocentralit Kosova e Re dhe Transaksioni i Termocentralit Kosova e Re janë komponentë përbërës të Strategjisë së Energjisë së Kosovës.

Ky transaksion është për investim në biznesin e prodhimit të energjisë elektrike. Transaksioni është i strukturuar përmes krijimit të një kompanie, GenCo qëllimi i vetëm i të cilës është prodhimi i energjisë. GenCo do të kontrakttojë edhe furnizimin me linjit nga Miniera e KEK-ut në formë të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit (MFL) dhe do t'ia kontrakttojë shitjen e energjisë elektrike dhe energjisë termike, Korporatës së Re Energjetike të Kosovës (KREK) për 100% të kapacitetit që ka në dispozicion Termocentrali Kosova e Re në formë të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE), Marrëveshjes së paraparë për Furnizim me Ngrohje dhe në fund KESCO-s, dhe të gjithë furnizuesve të tjerë, përmes nën-kontraktimit të MBE-së (Back-to-Back).

Të gjitha obligimet e Blerësit (Offtaker), sipas Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, Marrëveshjes së paraparë për Furnizim me Ngrohje, si dhe obligimet e Mihjes së KEK-ut sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit do të garantohen nga Qeveria e Kosovës.

11. CILËT JANË KOMPONENTËT KRYESORË TË PROJEKTIT?

Projekti është zhvilluar me kalimin e kohës për t'iu përshtatur politikave të reja, kushteve ekonomike dhe financiare, si dhe për të marrë parasysh profilet e rreziqeve të pranueshme për ofertuesit dhe huadhënësit e tyre në tregjet e sotme.

Pas shqyrtimeve të kujdeseshme të shumë faktorëve lidhur me atë që u tha më lartë dhe të inputit të ofertuesve, struktura e transaksionit tani përbëhet vetëm nga komponentët e termocentralit si më poshtë:

Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e termocentralit të ri nga linjiti, Termocentralit Kosova e Re, me kapacitet të instaluar prej 500 MW, me mundësi që të përdoret për kogjenerim me së paku 10% të kapacitetit të tij neto, punët për kyçje në rrjet, përgatitja për kapjen e karbonit, si dhe lokacionet për eliminimin e hirit dhe gjipsit.

12. KUSH E MBIKËQYR PROJEKTIN?

Qeveria e Kosovës e ka krijuar Komitetin Drejtues të Projektit (KDP), i cili përbëhet nga ministrat përkatës dhe rregullatorët e pavarur, me qëllim të përzgjedhjes së një investitori për Transaksionin e Termocentralit Kosova e Re.

KDP kryesohet nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), ndërsa anëtarët e tjerë janë nga Zyra e Kryeministrit (ZKM), Ministria e Financave (MF), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM).

Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP) e themeluar në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) është ajo që e menaxhon projektin e TCKR-së në baza ditore.

Projekti, po ashtu i ka të kontraktuar këshilltarët e transaksionit, këshilltarët ligjorë dhe teknikë dhe mbështetet nga asistencë teknike e financuar nga donatorët.

13. SI ËSHTË DUKE E PËRFSHIRË QEVERIA E KOSOVËS SEKTORIN PRIVAT NË ZHVILLIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Për zhvillimin e Termocentralit Kosova e Re, Qeveria e Kosovës ka vendosur të përfshijë sektorin privat në një proces konkurrues me dy faza: 1) Para-kualifikimi i Ofertuesve, dhe 2) Përzgjedhja e ofertuesit të preferuar bazuar në përgjigjet në Kërkesën për Propozime.

Nga koha e publikimit të Ftesës për Shprehjen e Interesit në vitin 2006, projekti është zhvilluar me kalimin e kohës për t'iu përshtatur politikave të reja (madhësia e termocentralit dhe komponentët e projektit siç është përfshirja e minierës dhe asetëve të termocentraleve ekzistuese në transaksion), kushtet ekonomike dhe financiare si dhe për të marrë parasysh profilet e rreziqeve të pranueshme për ofertuesit dhe huadhënësit e tyre në tregjet e sotme.

Në vitin 2014 kërkesa për Propozime iu lëshua tre ofertuesve të mbetur. Kërkesa për Propozime parashihte një proces në dy faza:

- **Faza 1:** Ofertuesit duhej të paraqisnin Normën e Brendshme fikse të Kthimit të Kapitalit (IRR), plus komponentin e Kostove Maksimale të Zhvillimit. Përcaktimi i Ofertuesit të preferuar bazohet në Ofertuesin që ka paraqitur IRR-në më të ulët të kapitalit dhe Koston Maksimale të Zhvillimit si pjesë e Propozimit të tyre Financiar të Fazës I. Ofertuesi i preferuar do të jetë përgjegjës për arritjen e Marrëveshjes Përfundimtare Komerciale; dhe

Nga lista e tre ofertuesve të para-kualifikuar, vetëm një ofertues i është përgjigjur Kërkesës për Propozim. Pas vlerësimit me kujdes të propozimit të paraqitur, i cili përfshinte një varg kushtesh, në vitin 2015 ofertuesit iu dha statusi i ofertuesit të preferuar dhe u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit për të pasqyruar rezultatet e negociatave që çojnë në arritjen e Marrëveshjes Komerciale (arritjen e Marrëveshjeve të Projektit).

- **Faza 2:** Pas Mbylljes Komerciale, partneri privat do të jetë përgjegjës për të zhvilluar një tender ndërkombëtar (sipas procedurave në përputhje me rregullat dhe politikat e IFN-ve) për kontraktuesin Inxhinieri-Prokurim-Ndërtim (EPC – Engineering Procurement Construction) dhe për Mirëmbajtje Afat-Gjate (LTM - Long Term Maintenance) nën mbikëqyrjen e Qeverisë, për aranzhimin e financimit të borxhit dhe për plotësimin e të gjitha kushteve paraprake dhe aktiviteteve të nevojshme për arritjen e Marrëveshjes Financiare. Në përgjithësi, tarifat e energjisë elektrike do të përcaktohen sipas metodologjisë, e cila merr parasysh kostot aktuale të EPC-së, LTM-së dhe çmimet e kontratës për Operim dhe Mirëmbajtje (O&M), çmimin e kontratës për punët e kycjes [në rret], kostot aktuale financiare dhe kostot e tjera të lejuara, siç është IRR do të mbesin konstante.

14. KUSH ËSHTË PARTNERI PRIVAT QË DO TË NDËRTOJË TERMOCENTRALIN?

ContourGlobal PLC (CG), një kompani e themeluar në SHBA, dhe tani kompani e listuar në Bursën e Londrës, e specializuar në sigurimin dhe zhvillimin e prodhimit të energjisë me shumicë me kontrata afatgjate për lloje të ndryshme të lëndës djegëse dhe në lokacione të ndryshme gjeografike.

CG është përfshirë në Transaksionin e termocentralit Kosova e Re që nga viti 2006, fillimisht si pjesë e ENEL / SENCAP (PPC / CG), e më vonë në vitin 2010 si anëtar i konsorciumit PPC/CG.

Portfolio e CG-së përfshinë 4.1 GW në operim, të shpërndara në 69 termocentrale që përdorin një varg të gjerë të lëndëve djegëse, teknologjive dhe pajisjeve që gjenden në 19 shtete në tre kontinente.

Për zhvillimin e Termocentralit Kosova e Re, CG do të ofrojë 30% të kostos së përgjithshme të projektit (afërsisht 400 milionë euro) përmes zotimeve të kapitalit në nivel të projektit me IRR të dakorduar prej 18.5% dhe do të jetë përgjegjëse për të aranzhuar financimin e borxhit të mbetur.

15. CILAT JANË AFATET KOHORE TË PROJEKTIT DHE CILAT JANË ZHVILLIMET E ARDHSHME KRYESORE?

Me arritjen e Mbylljes Komerciale (ku përfshihen të gjitha Marrëveshjet Komerciale të Projektit) Projekti i Termocentralit Kosova e Re hyn në Fazën II – Mbyllja Financiare. Mbyllja Financiare është faza e fundit para fillimit të ndërtimit.

Zhvillimet kryesore të Fazës II përfshijnë:

- Përzgjedhja e kontraktuesit të EPC dhe LTM dhe Kontraktuesit për punët e kyçjes [në rrjet];
- Përfundimi i Studimit Plotësues të EIA/ESIA
- Aplikimi dhe dhënia e të gjitha Lejeve dhe Licencave GenCo-s
- Plotësimi i të gjitha Kushteve Paraprake.
- Arritja e Marrëveshjeve Direkte me Huadhënësit.
- Mbyllja financiare/Data e transferimit të lokacionit.

Pasi të arrihet Mbyllja Financiare projekti do të hyjë në Fazën përfundimtare të Zhvillimit dhe Operimit.

Zhvillimet kryesore të Fazës së Zhvillimit dhe Operimit përfshijnë:

- Data e Fillimit të Ndërtimit (TCKR) brenda 30 ditëve kalendarike pas Mbylljes Financiare;
- Periudha e ndërtimit dhe lëshimit në funksion brenda 52 muajve;
- Data e Operimit Komercial (COD) në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

Në fund të periudhës 20 vjeçare të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, Termocentrali Kosova e Re i bartet Qeverisë së Kosovës pa asnjë kosto.

16. CILAT JANË MARRËVESHJET KONTRAKTUESE TË PROJEKTIT?

Ky transaksion është i strukturuar përmes krijimit të një kompanie të vetme që ka për qëllim vetëm prodhimin, GenCo. GenCo do të hyjë në një numër Marrëveshjesh të Projektit me Qeverinë e Kosovës dhe subjektet në pronësi të Qeverisë së Kosovës, siç është KOSTT, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ndërmarrja hidroekonomike Ibër-Lepenci (IL).

Sipas këtyre marrëveshjeve, Qeveria e Kosovës do të lëshojë garanci të pagesës dhe performancës për obligimet e Blerësit (Offtaker) (KREK) ndaj GenCo sipas PPA-së; obligimet ndaj Minierës së KEK-ut sipas MFL; dëmet që dalin nga Marrëveshja për Largimin e Hirit dhe Gjipsit; dhe për mos-furnizim me ujë sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë.

Sponsorët e partnerit privat (kompanitë e ContourGlobal) do të duhet të hyjnë në Marrëveshje për Mbështetje të Sponsorëve me Qeverinë e Kosovës për të adresuar zotimin e tyre për të siguruar kapitalin me kohë, për të ofruar siguri financiare gjatë zhvillimit të Termocentralit Kosova e Re dhe për të adresuar disa kufizime të caktuara në transferin e aksioneve, mes tjerash.

GenCo ka hyrë në këto kontrata lidhur me Termocentralin Kosova e Re: Marrëveshja për Transferimin e Lokacionit, Marrëveshja për Zbatim, Marrëveshja për Furnizim me Linjit, Marrëveshja për Blerje të Energjisë, Marrëveshja për Furnizim me Ujë, Marrëveshja për Kyçje [në rrjet] dhe Marrëveshja për Largimin e Hirit dhe Gjipsit.

Në Mbylljen Komerciale janë realizuar këto marrëveshje të projektit:

Nr.	Marrëveshja	Palët nënshkruese
1	Marrëveshja e Zbatimit (MZ)	GenCo/ QK
2	Marrëveshja e Mbështetjes së Sponsorëve (MMS)	GenCo/ QK
3	Marrëveshja e Transferimin në Lokacion (MTL)	GenCo/ KEK
4	Marrëveshja e Blerjes së Energjisë (MBE)	GenCo/ QK
5	Marrëveshja e Furnizimit me Linjit (MFL)	GenCo/ KEK
6	Marrëveshja e Furnizimit me Ujë (MFU)	GenCo / Ibër Lepenci

7	Marrëveshja e Lidhjes në Rrjet (MLRR)	GenCo / KOSTT
8	Marrëveshja e Largimit të Hirit dhe Gjipsit (MLHGJ)	GenCo/ KEK

Parashikohet që GenCo në të ardhmen të mund të kontrakttojë edhe shitjen e ngrohjes Termokosit në formë të Marrëveshjes për Furnizim me Ngrrohje.

Përveç këtyre Marrëveshjeve GenCo duhet të kërkojë lejet, pëlqimet dhe aprovimet e nevojshme për zhvillimin dhe ndërtimin e termocentralit Kosova e Re në institucionet përkatëse të përcaktuara me legjislacionin përkatës. Kërkesat e tanishme për licencim që aplikohen për GenCo përfshijnë (por nuk kufizohen në):

- Licenca për prodhim të energjisë elektrike, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)
- Autorizimi Mjedisor, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Leja Mjedisore, MMPH
- Leja e Integruar Mjedisore, MMPH
- Leja e Ujit, MMPH
- Leja e Ndërtimit, MMPH
- Leja e Përdorimit, MMPH

Sipas Ligjit të Kosovës Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (PKIN), GenCo do të aplikojë për leje të PKIN-së e cila i harmonizon standardet mjedisore në Kosovë për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes me ato të BE-së. Në pajtim me nenin 20 të këtij ligji, GenCo do t’ia paraqes Vlerësimin e Teknikave më të Mira të Mundshme Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të përcaktuar se teknologjitë dhe teknikat e propozuara për tu përdorur nga GenCo (dhe Kontraktuesi i tyre EPC dhe LTM dhe Kontraktuesi për punët e Lidhjes) janë në përputhje me masat për parandalimin, minimizimin dhe kontrollin e ndotjes dhe të bazuara në BREF-të.

17. KUSH DO TË SIGUROJË LINJITIN PËR TERMOCENTRALIN E RI?

Divizioni i Mihjes i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) do të ketë të drejtën ekskluzive për të eksploruar një zonë të caktuar të fushës së linjtit me rezerva të mjaftueshme për të siguruar linjit për përmbushjen e zotimeve të tij sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit (MFL) dhe të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit që i është dhënë për zhvillimin dhe operimin në zonat e përcaktuara të fushës për të përmbushur kërkesën për linjit nga prodhimi i licencuar i GenCo-s në Termocentralin Kosova e Re, bashkë me TC Kosova A dhe TC Kosova B për jetëgjatësinë e parashikuar ekonomike të shfrytëzimit të secilit termocentral. Miniera e KEK do të jetë e obliguar që të furnizojë të gjithë gjeneratorët në mënyrë të barabartë prioritare dhe çmimet e linjtit duhet të përcaktohen dhe mbahen në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë blerësit e linjtit.

Miniera e KEK-ut do të marrë përgjegjësinë për të gjitha elementet e mihjes së linjtit lidhur me Termocentralin Kosova e Re, përfshirë zhvillimin e minierës, investimin kapital, përmbushjen e të gjitha obligimeve mjedisore, sociale dhe të shëndetit dhe sigurisë, dhënien e licencave dhe lejeve, caktimi i çmimeve të linjtit, përmbushja e obligimeve kontraktuese të furnizimit, dhe përgjithësisht kryerja e të gjitha veprimeve dhe obligimeve lidhur me mihjen sipas kushteve të aplikueshme.

Miniera e KEK-ut do të marrë përgjegjësinë për të gjitha obligimet mjedisore lidhur me fushën e mbuluar nga Licenca ose leja e saj minerare.

Qeveria e pranon se GenCo kërkon garanci se Divizioni i Mihjes i KEK-ut do të kenë të gjitha kapacitetet për të zhvilluar dhe zbatuar planin e zhvillimit të minierës dhe për të përmbushur të gjitha obligimet dhe aktivitetet e mihjes në mënyrë që t’i mundësojë asaj të përmbush të gjitha obligimet e saj. Obligimet e furnizimit që ka divizioni i mihjes i KEK-ut ndaj GenCo do të garantohen nga QK.

Për të ndihmuar që të sigurohet besimi i GenCo-s se divizioni i Mihjes i KEK-ut do të jetë furnizues i qëndrueshëm afatgjatë i lëndës së parë për Termocentralin Kosova e Re (bashkë me termocentralet e tjera), KEK-u do të përdor mbështetjen e konsulentit ndërkombëtar të mihjes për përgatitjen e Planit të Zhvillimit të Minierës për minierën e re.

Divizionii i mihjes i KEK-ut, me mbështetjen e konsulentit ndërkombëtar të mihjes, është përgjegjës për:

- a) përditësimin e Planit të Zhvillimit të Minierës i KEK-ut për të marrë parasysh zhvillimet e nevojshme të minierës që kërkohet për furnizimin e Termocentralit Kosova e re për periudhën e shfrytëzimit të tyre, bashkë me furnizimin e termocentraleve të tjera dhe konsumatorëve të linjimit në Kosovë;
- b) zhvillimin e Planit të Financimit të Minierës (i cili mes tjerash do të adresojë financimin e kostove të nevojshme kapitale të kërkuara për zbatimin e Planit të përditësuar të Zhvillimit të Minierës);
- c) Raporti i Caktimit të Çmimit të Linjimit, i cili do të rekomandojë nivelin e çmimit të linjimit do të mundësojë operimin e qëndrueshëm të minierës së KEK-ut;
- d) asistencë për të arritur me kohë vazhdimin e licencës ekzistuese të mihjes nga divizionii i mihjes i KEK-ut dhe modifikimet e një licence të tillë për të pasqyruar Planin e përditësuar të Zhvillimit të Minierës dhe arritjen e të gjitha lejeve, licencave dhe aprovimeve të nevojshme; dhe
- e) planifikimi dhe zbatimi i të gjitha masave të nevojshme për të përmbushur obligimet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë të divizionit të mihjes të KEK-ut përfshirë ESA/ESIA dhe EMP-të lidhur me elementet e mihjes, dhe obligimet e zhvendosjes dhe ri-sistemit.

Plani i Zhvillimit të Minierës do të finalizohet në vitin 2018.

18. ÇFARË GARANCISH ËSHTË DUKE I DHËNË QEVERIA E KOSOVËS PARTNERIT PRIVAT, DHE A KËRKOJNË KËTO GARANCI APROVIM NGA PARLAMENTI?

Qeveria e Kosovës do të lëshojë garanci të pagesës dhe performancës për obligimet e Blerësit (Offtaker) ndaj GenCo sipas Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (MBE); obligimet e Divizionit të Mihjes së KEK-ut sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit (MFL); dëmet që dalin nga Marrëveshja për Largimin e Hirit dhe Gipsit, mos-furnizim me ujë sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë (MFU).

Garancitë e dhëna nga Qeveria e Kosovës pritet të mbështeten edhe nga Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) në formë të garancive që mbulojnë elementet e pavarura të rrezikut, përfshirë shkeljen e kontratës nga Qeveria e Kosovës.

Dhënia e garancive të tilla nënkupton që Qeveria e Kosovës është duke marrë obligime të mundshme, dhe ato duhet të ratifikohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 18. *Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare*).

19. KUSH DO TË FINANCOJË NDËRTIMIN E TERMOCENTRALIT?

CG do të ofrojë 30% (përafërsisht 400 milionë euro) të kostos së përgjithshme për zhvillimin e Termocentralit Kosova e Re përmes zotimeve të kapitalit në nivel të projektit, dhe do të jetë përgjegjës për aranzhimin e pjesës së mbetur përmes financimit të borxhit. GenCo pritet që menjëherë të fillojë procesin e identifikimit dhe kërkimit të interesit të kreditorëve të mundshëm ndërkombëtar për projektin, përfshirë atë të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN), Agjencive të Kreditimit të Eksportit (ECA), Bankave Ex-Im, kreditorëve komercialë dhe institucioneve potenciale kredituese të furnizuesit. Kuptohet se ECA-të potenciale, Bankat Ex-Im dhe institucionet kreditore të furnizuesit ka mundësi të lidhen me ofertuesin fitues të Kontratës EPC dhe LTM, Kontratës për punë të lidhjes të Fazës 2.

Secili prej IFN-ve ka shprehur interesin, në parim, që të ofrojnë përkrahje financiare për projektin e Termocentralit Kosova e Re që do të aplikohet për Ofertuesin e suksesshëm dhe kreditorët e tyre për të ndihmuar në zbutjen e disa rreziqeve të caktuara financiare që lidhen me Projektin e Termocentralit Kosova e Re.

Në janar të vitit 2012, Banka Botërore ka publikuar studimin "Kosovë: Projekti Energjetik i Kosovës - Raporti i Panelit të

Ekspertëve të Jashtëm të SFDCC-së për Bankën Botërore, në të cilin bazohet mbështetja e Grupit të Bankës Botërore për Projektin e TCKR-së bazuar në kriteret ekonomike, mjedisore, sociale dhe kriteret e tjera të Bankës Botërore. Me 13 mars 2012, Nënkrjetari i Bankës Botërore për Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore i dërgoi Kryeministrit të Kosovës një letër me Deklaratë të Mbështetjes “në parim”. Letra “në parim” paraqiste gatishmërinë e subjekteve të Grupit të Bankës Botërore për të marrë në konsideratë ofrimin e mbështetjes financiare për Projektin e Termocentralit Kosova e Re bazuar në gjetjet e Panelit të Ekspertëve të Jashtëm. Me 13 prill 2012, Banka Botërore ia dërgoi Ministrit të Financave të Kosovës një letër të titulluar “Deklarata e Mbështetjes së Grupit të Bankës Botërore për Garancinë e Pjesshme të Rrezikut”. Kjo letër paraqet një deklaratë nga Grupi i Bankës Botërore që thekson se subjektet e mëposhtme të Grupit të Bankës Botërore janë të gatshme, në parim, që të marrin në konsideratë të ofrojnë lloje të ndryshme të mbështetjes financiare për Projektin e Termocentralit Kosova e Re për investitorët ndërkombëtarë:

- Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC): të sigurojë fonde nga llogaria e saj dhe të ndihmojë Ofertuesin e suksesshëm në mobilizimin e IFI-ve të tjera, bankave komerciale dhe kreditorëve të tjerë, aty ku është e mundur dhe sipas kriterëve potenciale të atyre kreditorëve;
- Agjencia Shumëpalëshe e Garancive për Investime (MIGA): të ofrojë garanci të investimeve për investitorët e kualifikuar ndërkombëtarë dhe/ose kreditorët, e cila do të garantojë rreziqet duke përfshirë: rreziqet e kufizimeve të transferit, shpronësimit, shkeljes së kontratës nga Qeveria e Kosovës (përfshirë obligimet e pagesës) dhe rreziqet nga lufta dhe mosbindja qytetare; dhe
- Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA): të ofrojë garanci, që mbulon elementet e rrezikut sovran, përfshirë në veçanti shkeljen e kontratës nga Qeveria e Kosovës.

Republika e Kosovës u bë shteti i 66-të anëtar i BERZH-it në dhjetor 2012. Kështu që Projekti i Termocentralit Kosova e Re u kualifikua për mbështetje nga BERZH, përfshirë mbështetjen financiare. BERZH ka shprehur një interesim në parim për ofrimin e mbështetjes financiare për Projektin e Termocentralit Kosova e Re. Me 9 prill 2013, BERZH i dërgoi një letër të mbështetjes në parim për Projektin e Termocentralit Kosova e Re Ministrit të Financave të Kosovës. Që nga dhjetori 2012, anëtarët e BERZH-it kanë marrë pjesë aktive në takime me Njësia për Implementimin e Projektit dhe Këshilltarët e Transaksionit, në përpjekje për të siguruar që Kërkesa për Propozime (RfP) dhe Marrëveshjet e Projektit të jenë të strukturuar në përputhje me standardet e BERZH-it.

20. KUSH DO TA NDËRTOJË TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?

GenCo do të jetë përgjegjëse për të zhvilluar një tender për ndërkombëtar për Kontraktuesit për Inxhinierim-Prokurim-Ndërtim (EPC) dhe Mirëmbajtje Afatgjate (LTM) dhe për punë të Lidhjes (Koneksionit).

Tenderët e tillë duhet të zhvillohen nën mbikëqyrjen e Qeverisë së Kosovës dhe procesi i tenderimit duhet të respektojë Standardet e Aplikueshme dhe standardet e prokurimit të IFN-ve. GenCo do të zhvillojë një proces të vetëm tenderimi dhe do të përzgjedh një Kontraktues fitues i cili do të ofrojë edhe shërbimet EPC edhe ato LTM, si dhe një tender të veçantë për punë të Lidhjes

21. KUSH DO TA KETË NË PRONËSI TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?

Termocentrali Kosova e Re do të jetë në pronësi të kompanisë prodhuese GenCo. Për 20 vitet e para, ose për kohën sa zgjat Marrëveshja e Blerjes së Energjisë (MBE), GenCo do të jetë në pronësi të Ofertuesit fitues (ContourGlobal). Në fund të periudhës së MBE-së, GenCo do t'i transferohet Qeverisë së Kosovës pa asnjë kosto.

22. KUSH DO TË OPEROJË ME TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?

Për 20 vitet e para, ose për kohën sa zgjat Marrëveshja e Blerjes së Energjisë (MBE), GenCo do të operohet nga partneri privat (ContourGlobal). Pas transferimit të GenCo-s tek Qeveria e Kosovës, kjo e fundit do të vendos se kush do të operojë me Termocentralin Kosova e Re për 20 vitet në vazhdim.

23. KUR DO TË FILLOJË NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT TË RI DHE SA DO TË ZGJAS AI?

Pas arritjes së Mbylljes Komerciale me 20 dhjetor 2017, zhvillimi i Termocentralit Kosova e Re varet nga arritja e Mbylljes Financiare në Fazën 2 të këtij transaksioni, marrjes me sukses të të gjitha licencave dhe lejeve përkatëse që kërkohen me legjislacionin në fuqi, dhe sigurimin me sukses nga GenCo dhe kontraktuesit e GenCo-s të të gjitha pëlqimeve të GenCo-s siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

GenCo duhet të arrijë Datën e Fillimit të Ndërtimit brenda 30 ditëve kalendarike nga Marrëveshja Financiare/Data e Transferit, dhe impianti duhet të arrijë datën e Operimit Komercial brenda 52 muajve pas datës së transferit. Aranzhimet e veçanta do të aplikohen për periudhat kur Termocentrali Kosova e Re do t'i nënshtrohet testimit për operim komercial dhe nga fillimi i operimit komercial të Termocentralit Kosova e Re.

Nëse GenCo dështon të përmbush cilëndo Datë të Operimit Komercial, dëmet e likuiduara do të aplikohen siç specifikohet në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

24. KUSH DO TË MBIKËQYR NDËRTIMIN DHE PRANIMIN E TERMOCENTRALIT?

Kërkohet që ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re të bëhet me metodologjinë e kontratës EPC "me çelësa në dorë" dhe se punët zhvillimore do të bazohet në Specifikimet e cekura Funksionale të Termocentralit Kosova e Re. Qeveria do të emërojë një Inxhinier të Pavarur për të monitoruar dhe për të qenë dëshmitar i zhvillimit dhe testimit të Termocentralit Kosova e Re në emër të QK/KREK-së (Blerësit). Qeveria e Kosovës do të jetë përgjegjëse për kostot e Inxhinierit të Pavarur siç përcaktohet në Marrëveshjen e Zbatimit.

25. KUR MUND TË PRESIM FURNIZIMIN E ENERGJISË SË PARË ELEKTRIKE?

Data e operimit komercial të Termocentralit Kosova e Re lidhet me:

1. Arritjen e Mbylljes Komerciale (arritjen e të gjitha Marrëveshjeve të Projektit) - e përfunduar
2. Arritja e Mbylljes Financiare (përmes një tenderi ndërkombëtar për kontraktuesin e EPC-së dhe LTM-së, kontraktuesin e punëve të Kçqjes, duke aranzhuar financimin e borxhit dhe duke përmbushur të gjitha kushtet paraprake)
3. Datën e Fillimit të Ndërtimit brenda 30 ditësh kalendarike pas Mbylljes Financiare/ Datës së Transferimit të Lokacionit.
4. Përfundimi i ndërtimit dhe testet e performancës brenda afatit 52 muajve nga Data e Fillimit të Ndërtimit.

Bazuar në ato që u thanë më lartë, parashikimi i furnizimit të parë me energji elektrike nga Termocentrali Kosova e Re është mesi i vitit 2023.

C. FAKTET E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE (TCKR)

26. KUSH DO TA KETË NË PRONËSI TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?

Termocentrali Kosova e Re (TCKR) përfshinë termocentralin me djegie linjitet me një njësi të vetme me kapacitet bruto prej 500 MW, ose kapacitet neto prej 450 MW, i vendosur në një hapësirë pranë TC ekzistues Kosova B në Obiliq, Kosovë. Kapaciteti i njësisë së re prej 500/450 MW është i përshtatshëm për integrim në rrjetin ekzistues të transmisionit sa i përket kapacitetit të rrjetit dhe stabilitetit të tij.

Njësia e re do të sigurojë energjinë bazë dhe stabilizim të rrjetit, dhe do të jetë aset kritik strategjik pasi që ai do të mbulojë pothuaj gjysmën e tërë kërkesës për energji elektrike në vend. Njësia e re do të jetë e gatshme për kogjenerim, dhe poashtu në të ardhmen do të sigurojë energji termike për sistemin e ngrohjes qendrore të Prishtinës, dhe me zgjerimin e rrjetit edhe për Fushë Kosovës dhe Obiliqi. .

27. ÇFARË TEKNOLOGJIE DO TË APLIKOHET NË TERMOCENTRALIN KOSOVA E RE?

Kërkesa për Propozim për Termocentralin Kosova e Re specifikon standardet mjedisore dhe teknike të cilat duhet të përmbush termocentrali i ri.

Njësia e planifikuar do të ndërtohet si termocentral "superkritik", duke përfaqësuar teknologjinë më të mirë të mundshme, dhe kërkohet të përmbush standardet e emetimit të DEI të BE-së me sistemet më bashkëkohore të djegies dhe kontrollit të cilësisë së ajrit. Eficienca neto e termocentralit të ri pritet të jetë më i lartë se 40.0%.

Në pjesën teknike të atyre standardeve, GenCo mund të përdor cilendo prej dy teknologjive të reja në vijim: Teknologjitë prodhuese me kaldaja me djegie të pluhurizuar të linjitet (PCC) ose Kaldaja me shtrat qarkullues të lëngëzuar (CFBC). I përket GenCo që gjatë asaj që njihet si Faza 2 e projektit të përcaktojë se cilën teknologji do të përdor. Sido që të jetë, duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme në lokacionin e caktuar për ndërtim për të akomoduar cilëndo teknologji prodhuese për Termocentralin Kosova e Re.

Përveç standardeve të teknologjisë së djegies së brendshme, Termocentrali Kosova e Re po ashtu do t'i nënshtrohet edhe kërkesave KRK (Kapjen dhe Ripërdorimin e Karbonit). Duhet theksuar se plani indikativ që ofron hapësirë për kapjen e ripërdorimin dhe sekuestrimin e karbonit mund të ndryshojë nga një dizajn në tjetrin. I përket GenCo-s dhe ofertuesve të Kontratës EPC dhe LTM, që të propozojnë plane alternative nëse dizajnet e tyre ndryshojnë nga plani indikativ.

Marrë së bashku, këto kërkesa do të sigurojnë që TCKR përdor teknologjinë më të mirë të mundshme dhe të menaxhojë në mënyrën më të mirë të mundshme, krejt kjo me qëllim të rritjes së furnizimit me energji, duke minimizuar rreziqet për mjedisin, dhe për shëndetin e komunitit përreth.

28. EFIÇIENCA E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE

Kërkesat minimale për eficientë termike të përcaktuar për Termocentralin Kosova e Re janë në përputhje me kërkesat e Teknikave më të Mira të Mundshme (BAT) të Direktivës së Bashkimit Evropian për Emetimin Industrial (IED). Eficienca neto është niveli i lëndës djegëse dhe ujit që nevojitet për operimin e termocentralit në raport me prodhimin e termocentralit.

Termocentrali Kosova e Re, një njësi e vetme me kapacitet bruto prej 500 MW do të duhet të arrijë standardin prej së paku 40.0% të eficientës elektrik neto. Pragjet minimale të aprovuara të eficientës janë përcaktuar në specifikacionet teknike për Termocentralin Kosova e Re.

Eficienca më e lartë nënkupton konsum më të ulët të linjitet, rrjedhimisht më pak emetim. Megjithatë, eficienca më e madhe arrihet me aplikimin e aliazheve të veçanta të cilat mund të tolerojnë parametra operativ më kërkues (temperatura dhe shtypje më të larta) e cila përkthehet në kosto më të larta të ndërtimit dhe mirëmbajtjes. Në përcaktimin e eficientës neto të termocentralit të ri, vëmendje i është kushtuar edhe demonstrimit të teknologjisë me kosto efektive për të shmangur rritjen

e panevojshme të tarifave elektrike për shkak të kostos së lartë të investimit kapital.

Për krahasim, gjatë vitit 2016, TC Kosova A ka patur efikasitet neto 27.2% ndërsa TC Kosova B 33.4%.

29. SA ENERGJI ELEKTRIKE DO TË PRODHOJË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE?

Termocentrali Kosova e Re do të ketë një kapacitet të instaluar prej 500 MW, që quhet kapacitet bruto. Proceset e brendshme, siç janë funksionimi i pompave të ndryshme, shiritave transportues, mullinjve, sistemeve për kontrollimin e cilësisë së ajrit, ndriçimi, instrumentet dhe humbjet zakonisht marrin 10% të kapacitetit të përgjithshëm bruto, që quhet konsum i brendshëm i termocentralit. 450 MW e mbetur janë në dispozicion për t'u shpërndarë në rrjet, që quhet kapaciteti neto, ose kapaciteti që mund të deklarohet se është në dispozicion për rrjetin.

Termocentrali Kosova e Re do të jetë në gjendje të operojë me një shkallë të fleksibilitetit, ndërmjet minimumit teknike prej 180 MW deri në 450 MW. Kapaciteti në të cilin termocentrali operon gjatë secilës orë përcakton prodhimin e energjisë. Kjo matet me MWh. Në rastet e operimit me kogjenerim, njësia mund të ofrojë 20 MW energji termike, por me një ulje prej 10% të prodhimit të energjisë elektrike.

Sa për ilustrim: nëse termocentrali operon me kapacitet prej 450 MW në orë ai mund të prodhojë 450 MWh ose nëse punon me kapacitet 450 MW për 24 orë atëherë ekuacioni duket kështu $450 \times 24 = 10,800$ MWh.

Po ta vëmë këtë në kontekst të Kosovës, kërkesa vjetore e vendit është rreth 5,500 GWh ose 5,500,000 MWh. Nëse TCKR do të punonte me mesataren e planifikuar që është ekuivalente me operimin me ngarkesë maksimale gjatë vitit, ai do të prodhojë $450 \text{ MW} \times 7,687 \text{ orë} = 3,459,150$ MWh, e mjaftueshme që ta plotësojë 63% të kërkesës.

Kjo llogaritje, megjithatë, përfshinë inspektimet periodike të njësisë, mirëmbajtjen vjetore, riparimet e mëdha që ndodhin çdo 5 vjet dhe riparimin kryesor çdo 10 vjet. Gjatë periudhave të tilla të riparimit, termocentrali është jashtë funksionit për një numër të caktuar muajsh. Në rastin më të mirë vjetor të operimit maksimal dhe pa periudha të mirëmbajtjes ose riparimit të madh, që do të thotë se termocentrali prodhon vazhdimisht energji elektrike, TCKR do të jetë në gjendje të prodhojë energji të mjaftueshme për të plotësuar 64.4% të nevojës mesatare vjetore të Kosovës për energji. Me kalimin e kohës dhe rritjes së kërkesës për energji, do të zvogëlohet pjesëmarrja e energjisë që prodhohet nga TCKR për plotësimin e nevojave të Kosovës për energji.

Termocentrali Kosova e Re po ashtu është i obliguar të dedikojë 10% të kapacitetit të vet neto të energjisë për energji termike (për ngrohjen e hapësirave). Kjo do të thotë se gjatë stinës së ngrohjes në muajt e dimrit, varësisht nga kërkesat specifike për ngrohje, TC Kosova e Re ka potencial që të sigurojë energji ekuivalente të ngrohjes prej rreth 200 MW_{th} .

30. SA LINJIT DO TË KONSUMOJË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE DHE SA ËSHTË KJO KRAHASUAR ME TERMOCENTRALET EKZISTUESE NË KOSOVË?

Termocentrali Kosova e Re me teknologji superkritike dhe efikasitet prej më shumë se 40% do të konsumojë më pak linjit se sa që konsumohet nga TC Kosova A dhe TC Kosova B. Linjiti për Kosovën e Re do të furnizohet nga miniera e afërt që operohet nga divizioni i minierave i KEK-ut.

Konsumi final i linjtit është një prej parametrave që do të përcaktohet nga Kontraktuesit EPC në Fazën 2, megjithatë, bazuar në kërkesat minimale të përcaktuara, konsumi i linjtit pritet të sillet prej 1.05 deri në 1.10 t / MWh (neto). Kërkesa e përgjithshme vjetore për linjit varet nga numri i orëve që njësia do të punojë gjatë vitit, e cila bazohet në llogaritjet se termocentrali do të konsumojë 3.8 - 4.0 milionë tonë linjit në vit.

Për krahasim, konsumi vjetor i linjtit gjatë vitit 2016 ishte 1.73 t/MWh (neto) për TC Kosova A, dhe 1.40 t/MWh (neto) për TC Kosova B.

Nevoja për termocentral me efikasitet më të lartë është me rëndësi pasi që kjo ndikon në koston përfundimtare të prodhimit duke ulur koston operative të termocentralit, emetimet në mjedis, dhe sasinë e hirit që duhet depozituar.

31. SA UJË DO TË KONSUMOJË KOSOVA E RE DHE A KA UJË TË MJAFTUESHËM PËR KËTË TERMOCENTRAL?

Termocentrali Kosova e Re do të furnizohet me ujë të papërpunuar nga Ibër-Lepenci sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë. Furnizimi ekzistues me ujë për Kosovën B nga kanali Ibër-Lepenc bëhet me rënies të lirë në një distancë prej një km nga kanali kryesor deri te termocentrali. Ibër-Lepenci do të bëjë aranzhimet për matjen e furnizimit me ujë të TCKR-së, në/ose afër Pikës së Furnizimit me Ujë siç specifikohet në Marrëveshjen për Furnizim me Ujë.

Minimizimi i konsumit të ujit është një aspekt i rëndësishëm i dizajnit të termocentralit. Termocentrali Kosova e Re përdor teknologji superkritike, eficienta prej më shumë se 40% dhe trajtim bashkëkohor të ujit, që mundësojnë që termocentrali të konsumojë më pak ujë se që konsumojnë aktualisht TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Trajtimi i ujit të papërpunuar kërkohet për qëllime të ndryshme dhe për të plotësuar nevojat e ndryshme të Termocentralit Kosova e Re, përfshirë, por jo domosdoshmërisht duke u kufizuar në, si vijon:

- ujë të pijshëm
- strukturën e demineralizuar të ciklit të avullit të ujit
- sistemet e ujit për fikjen e zjarrit
- strukturën e ujit për ftohje
- desulfurizimin e gazit të oxhakut (nëse kërkohet)
- sistemet e trajtimit të hirit
- shtypjen e pluhurit në zonën e trajtimit të linjtit
- qëllime të tjera të shfrytëzimit të ujit për shërbime të përgjithshme (p.sh., ujit për gypa).

GenCo duhet të bëjë trajtimin e ujit të papërpunuar për të përmbushur këto kërkesa, dhe të përzgjedh pajisjet për të siguruar trajtim dhe kontroll të duhur për nevojat e Termocentralit Kosova e Re.

Konsumi përfundimtar i ujit të papërpunuar është një prej parametrave që do të përcaktohen nga Kontraktuesit EPC në Fazën 2. Megjithatë, bazuar në rezultatet preliminare të studimit, kërkesat e përgjithshme të termocentralit për ujë të papërpunuar planifikohen të jenë rreth $2.16 \text{ m}^3 / \text{MWh}$ (neto) për njësinë që operon me kapacitet nominal. Për krahasim, konsumi i ujit nga TC Kosova B në vitin 2016 ishte rreth $2.406 \text{ m}^3 / \text{MWh}$ (neto), dhe kjo për faktin se shumica e ujit nuk është trajtuar dhe ripërdorur në sistem.

Studimi i fizibilitetit për Mbrojtjen e Kanalit Ibër Lepenc në Kosovë (Vëllimi A, Raporti Kryesor, 2015, egis eau) jep të dhëna të mjaftueshme për ujin e papërpunuar në dispozicion dhe furnizimin me ujë të papërpunuar për gjithë jetëgjatësinë e Termocentralit Kosova e Re. Në fakt, ky studim ka konfirmuar bilancet e ujit nga studimet e mëhershme (2008 dhe 2014) se kapaciteti i ujit në fund të kanalit kryesor ekzistues të lbrit është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesën për ujë të papërpunuar edhe për kapacitetet ekzistuese edhe për ato të reja të termocentralit me linjit.

D. NDIKIMET MJEDISORE TË KOSOVËS SË RE

32. CILAT JANË STANDARDET MJEDISORE TË NDJEKURA PËR DIZAJNIMIN DHE OPERIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Qeveria ka marrë vendim për kërkesat minimale të efijencës termike të nevojshme për të qenë në përputhje me kërkesat e Teknikave më të Mira të Mundshme (BAT) të Direktivës së Bashkimit Evropian për Emetimin Industrial (IED).

TCKR do të duhet të arrijë standardin e Efijencës Elektrike Neto prej së paku 40.0% (që aplikohet për të gjitha kategoritë e dizajneve për objektet e Termocentralit Kosova e Re).

Kërkesat për kontrollin e niveleve të oksidit të hidrogjenit ("NO_x"), dyoksidit të sulfurit ("SO₂"), dhe materies së grimcave ("pluhuri") që lirohet në atmosferë përcaktohen në IED dhe aplikohen për termocentralet ekzistuese dhe të reja që djegin lëndët e ngurta, lëngëta ose të gazta. Këto kërkesa specifikojnë nivelet që varen nga vjetërsia e termocentralit. Në kontekstin e IED, impianti i TCKR kategorizohet si termocentral i ri me djegie të lëndës së parë të ngurtë dhe me input termik më të madh se 300 MWth. Prandaj, për të mundur respektimin e IED-së, GenCo duhet të sigurojë që termocentrali të respektojë këto vlera të kufizuara të emetimit:

BAT-AELs	Kaldaja me shtrat qarkullues të lëngëzuar		Kaldaja me djegie të pluhurizuar	
	Mesatarja vjetore	Mesatarja ditore	Mesatarja vjetore	Mesatarja ditore
Ndotësi	mg/Nm ³	mg/Nm ³	mg/Nm ³	mg/Nm ³
SO ₂	20 - 75	25 - 110	10 - 75	25 - 110
NO _x	50 - 85	80 - 125	65 - 85	80 - 125
Pluhuri	2 - 5	3 - 10	2 - 5	3 - 10

Komisioni për zbatimin e vendimit (EU) 2017/1442 të 31 korrikut 2017, për përcaktimin e konkluzionit për teknikat më të mira të mundshme (BAT), sipas Direktivës 2010/75/EU së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.

Direktiva 2009/31/EC për ruajtjen gjeologjike të dioksidit të karbonit e ndryshuar me LCPD për të kërkuar nga të gjitha termocentralet me djegie të brendshme të cilave u jepet licenca pas 23 prillit 2009 që të vlerësojnë, dhe ku është e realizueshme të vënë në dispozicion hapësirën e përshtatshme në lokacion për kapjen dhe kompresimin e CO₂. Termocentrali Kosova e Re duhet të jetë i gatshëm për Kapjen e Karbonit. Lokacioni i TCKR-së ofron hapësirë adekuate për instalimin e teknologjisë për nxjerrjen e CO₂ për të qenë në përputhje me Direktivën 2009/31/EC.

33. SI ËSHTË PËRZGJEDHUR LOKACIONI PËR NDËRTIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Kriteret e përzgjedhjes së lokacionit për termocentralin përfshinë:

- sipërfaqe toke të pashfrytëzuar ose që mund të lirohet lehtë
- mundësisht e përcaktuar si zonë për aktivitete industriale
- topografi relativisht e rrafshët
- kushte të arsyeshme të dheut, pa zona seizmike në afërsi, pa rrezik vërshimi
- të jetë në kahun tjetër të erës nga qendrat e populluara dhe jo në afërsi të qendrave të banimit
- të jetë larg parqeve natyrore, botës shtazore dhe zonave arkeologjike
- të mos ketë dukshmëri të lartë
- vlerësim të kënaqshëm ekonomik.

Një para-studim i fizibilitetit në vitin 2006 fillimisht kishte identifikuar tri lokacione: pranë TC Kosova B, në Bivolak dhe në Grabovc të Poshtëm. Në fillim të vitit 2007 u shtua edhe një lokacion i mundshëm pranë TC Kosova A, duke zëvendësuar atë

në Grabovc të Poshtëm, i cili doli të jetë i papërshtatshëm.

Lokacioni i përzgjedhur për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re është pranë TC Kosova B. Lokacioni është një fushë industriale që gjendet përafërsisht 1.5 kilometra në perëndim të Obiliqit dhe 9 kilometra në perëndim të Prishtinës.

Ky lokacion u përzgjedh me qëllim që të shfrytëzohet plotësisht infrastruktura energjetike që tashmë ekziston atje siç është, toka që tashmë është në pronësi të KEK-ut, afërsia me nënstacionin 400/220 të Kosovës B të KOSTT-it, afërsia me kanalin e ujit Ibër-Lepenci, rruga ekzistuese dhe rrjeti hekurudhor, e të ngjashme.

Plani i termocentralit do të rregullohet që:

- Të ofrojë siguri dhe efikasitet të operimit dhe mirëmbajtjes
- Minimizojë trafikun në lokacion
- Marrë parasysh drejtimin e erërave mbizotëruese sa i përket:
 - ndikimit të pluhurit nga oborri i trajtimit të qymyrit në pajisjet dhe objektet e ndjeshme
 - qarkullimit të ajrit të nxehtë nga kullat ftohëse, era dhe tymi
 - sigurimit të ajrit të pastër për ndërtesat, pajisjet aktuale dhe të ardhshme
- Të optimizojë sinergjitë e mundshme me termocentralin ekzistues Kosova B përmes shërbimeve të përbashkëta
- Të lehtësojë reagimet nga ekipet emergjente siç janë zjarrfikësit
- Të mos ketë ndikim në aktivitetet e operimit dhe mirëmbajtjes së Kosovës B
- Të mos ketë ndikim në Trafikun Ajror (oxhaku)
- Të lidh TCKR-në me shkëmbyesin e nxehtësisë që ndodhet në ose afër TC Kosova B.

Lokacioni vlerësohet të ketë hapësirë të mjaftueshme për nxjerrjen e karbonit. Përderisa merret një vendim i ardhshëm i qeverisë për të instaluar teknologjinë e kapjes së karbonit në TCKR, duhet të identifikohen dhe zhvillohen rezervuarë të mjaftueshme për ruajtjen e karbonit dhe infrastrukturën e transportit.

34. SI JANË VLERËSUAR NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE PËR KËTË PROJEKT?

Një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për Termocentralin e propozuar Kosova e Re (TCKR) është përgatitur në vitin 2014 për të identifikuar rreziqet mjedisore dhe sociale, ndikimet dhe mundësitë që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe operimin e TCKR-së, që në atë kohë ishte propozuar të ketë një kapacitet prodhues prej 600MW. VNMS-ja rekomandoi gjithashtu masa përkatëse zbutëse për të parashikuar dhe shmangur, ose kur shmangia nuk është e mundur, për të minimizuar dhe, aty ku ndikimet e mbetjeve, për të kompensuar ose mënjeluar ndikimet e tilla. VNMS-ja gjithashtu e analizoi infrastrukturën tjetër lidhur me TCKR-në, veçanërisht mundësitë për minierën që do të mund të furnizonte me linjit termocentralin dhe elementet përkatëse të kanalit Iber-Lepenc, i cili furnizon me ujë përdoruesit e shumtë dhe do të furnizonte TCKR-në me ujë për ftohje.

VNMS-ja u përgatit në përputhje me kërkesat e institucioneve financiare ndërkombëtare (IFI-të), përkatësisht Politikën Operacionale (PO) mjedisore dhe sociale të Bankës Botërore, Standardet e Performancës (SP) mjedisore dhe sociale të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Kushtet e Performancës (KP) mjedisore dhe sociale të Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillimin (BERZH). VNMS gjithashtu merr parasysh legjislacionin e aplikueshëm mjedisor dhe social nga Republika e Kosovës dhe Direktivat e Bashkimit Evropian.

Përgatitja e VNMS-së ka përfshirë angazhimin e komunitetit dhe palëve të interesit, përmes shpalosjes së informacionit të projektit dhe konsultimeve me palët vendore të interesit dhe komunitetet lokale për çështje që i prekin ata drejtpërdrejt.

Inputet në VNMS përfshinë Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) për projektin e propozuar shumë më të madh Kosova C (2,000 MW), i cili është përgatitur prej shtatorit 2007 deri në mesin e vitit 2008.

VNMS u përgatit në dy faza:

- **Faza 1** - Faza e vlerësimit të fushëveprimit, e fokusuar kryesisht në identifikimin e ndikimeve që duhet të vlerësohen, si të vlerësohen ato dhe cilat nga ndikimet janë më domethënëse dhe më të rëndësishme, si dhe shqyrtimin e ndikimit të zonës gjeografike për parametrat mjedisore dhe sociale. Kjo fazë ka përfshirë konsultime publike mbi Raportin e vlerësimit të fushëveprimit.
- **Faza 2** - Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social - bazuar në gjetjet e Fazës së Vlerësimit të fushëveprimit dhe konsultimeve - duke u përqendruar në vlerësimin e ndikimit të tanishëm dhe identifikimin e masave të propozuara lehtësuese mjedisore dhe sociale dhe për masën monitoruese për të informuar zhvillimin e planeve specifike të menaxhimit në të ardhmen.

Procesi i gjerë i konsultimeve i ndërmarrë për VNMS ka tentuar të identifikojë shqetësimet e komunitetit dhe të përcaktojë prioritetet mjedisore dhe sociale për zhvillimin e minierave të linjitet dhe prodhimin e energjisë, dhe në veçanti që:

- Të sigurojë se janë identifikuar palët kryesore të interesit
- Të mbledh opinionet/pikëpamjet/perceptimet e opinionit publik mbi gjendjen aktuale të çështjeve mjedisore dhe sociale dhe pritjet për të ardhmen
- Të jap informacione mbi karakterin, progresin dhe ndikimet e projektit tek palët kryesore të interesit
- Të jap palëve të interesit mundësinë për të ndikuar në prioritetet e politikave që ndikojnë në këtë proces
- T'ua shpalos Raportin e fushëveprimit dhe draft raportin e VNMS-së palëve të interesit dhe popullatës së prekur për komente që do të përfshihen në VNMS-në përfundimtare.

Aktivitetet kryesore të konsultimit të kryera për VNMS-në ishin si më poshtë:

- Konsultimet publike për/dhe publikimi i Termave të Referencës në korrik 2012
- Identifikimi i palëve kryesore të interesit si pjesë e Raportit të fushëveprimit
- Publikimi dhe dëgjimi publik i Raportit të fushëveprimit në tetor 2014
- Anketa socio-ekonomike me 2,050 persona, si dhe grupet e fokusit në fshatrat e komunës së Obiliqit në vitin 2014 (rreth 20% e popullsisë së prekur në zonën e ndikimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë)
- Konsultimet mbi draftin e VNMS-së, të cilat duhet të zhvillohen një muaj pas publikimit të draft dokumentit.

VNMS aktualisht është duke u përditësuar (2017-2018) për të pasqyruar kapacitetin e planifikuar aktual prej 450MW. VNMS e përditësuar nuk adreson ndikimet nga operacionet e minierave të linjitet, të cilat kërkojnë vlerësim në një studim të veçantë.

35. CILAT JANË NDIKIMET E PARASHIKUARA MJEDISORE DHE SOCIALE GJATË NDËRTIMIT TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Ndikimet e mundshme negative gjatë ndërtimit përfshijnë pluhurin, zhurmën, çrregullimet në modelet e trafikut dhe rrezikun e lëndimit të punëtorëve të ndërtimit. Këto ndikime janë të përkohshme dhe të kufizuara në fazën e ndërtimit dhe do të zbuten me kontrollin dhe mbikëqyrjen e duhur të ndërtimit, në mënyrë që ndikimet të jenë minimale.

Ndikimet e mundshme pozitive përfshijnë rritjen e mundësive të punësimit gjatë ndërtimit.

36. CILAT JANË NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE GJATË OPERIMIT TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Përfitimi i madh pozitiv i operimit të termocentralit të ri përfshinë përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe shëndetit publik nga operacionet më efikente të termocentralit dhe reduktimin e emetimeve në ajër me filtra më të mirë dhe teknologji të djegies, si dhe masat për të përmbushur standardet e DEI-të për kontroll të ndotjes. Përfitimet e tjera pozitive përfshijnë rritjen e të

ardhurave të qeverisë dhe mundësitë e punësimit. Një ndikim i madh negativ pritet nga zgjerimi i operacioneve të minierave që do të kërkojnë zhvendosjen e njerëzve. Megjithatë, zbutja e planifikuar mund të ndihmojë në uljen e këtij ndikimi me dispozita të veçanta në Planin e Veprimit për Zhvendosje dhe mbështetjen financiare ose të punësimit nëpërmjet Fondit për Zhvillimin e Komunitetit dhe Strategjisë së Akomodimit në Punë.

Ndikimet e veçanta mjedisore nga operimi i termocentralit përfshijnë:

- Përhapja e pluhurit që ngrihet nga transporti dhe trajtimi i linjtit (Ndikim i parëndësishëm me kontrollin e planifikuar për zbutjen dhe kontrollin e pluhurit)
- Emetimet në ajr të tilla si SO_x , NO_x , CO, CO_2 , lëndë në formë të grimcave (LG), disa metale të rënda dhe përqendrime të vogla të dioksinave nga djegia e linjtit (ndikimi i vogël i SO_x me de-sulfurizimin dhe masat e tjera të planifikuara të kontrollit për zbutjen e emetimeve; dhe ndikimi i madh pozitiv në cilësinë e ajrit për shkak të operacioneve më efikase dhe metodave të heqjes së emetimeve)
- Emetimi i mikrobeve siç janë bakteret dhe legionella nga kullat ftohëse (ndikim i parëndësishëm me zbutjen e planifikuar)
- Ndotja e ujit nga ujërat e zeza të termocentralit (ndikim i vogël me zbutjen e planifikuar të trajtimit të ujërave të zeza)
- Zgryra, hiri, mbetjet e nën-produkteve të gjipsit nga prodhimi i energjisë (ndikim të vogël me zbutjen e planifikuar)
- Ndotja e ujit nga ujërat e zeza të minierës (ndikim i moderuar me zbutjen, përfshirë monitorimin e cilësisë së ujit)
- Më pak ujë në dispozicion për furnizim me ujë të vendbanimeve lokale (ndikim i parëndësishëm me zbutjen)
- Humbja e habitateve biologjike për shkak të minierave (ndikimi i parëndësishëm me zbutjen)
- Trazimi i Xhamisë dhe Monumentit të Dëshmorëve të UÇK-së në Hade (ndikim i vogël deri në ndikim të parëndësishëm nëse zhvendosen në lokacione alternative)
- Trazimi i monumenteve/pemëve botanike të Mexhuanëve dhe Nicaj (ndikim i parëndësishëm me përpjekjet për ruajtje)
- Pamundësia e shfrytëzimit të tokës dhe humbja e stabilitetit të tokës për shkak të minierave të thëngjillit (ndikim i moderuar me rehabilitimin dhe masa të tjera zbutëse)
- Ndotja e dheut dhe ujit nga minierat (ndikimi i vogël me zbutjen)
- Zhurma nga makineritë në miniera dhe termocentral (ndikimi i vogël me zbutjen)
- Rreziku i ekspozimit ndaj materialeve të rrezikshme, djegies dhe kontaminimit të tokës afër aktiviteteve të minierave (ndikimi i parëndësishëm me zbutjen).

Ndikimet specifike sociale përfshijnë:

- Përmirësimin e shëndetit për shkak të përmirësimit të cilësisë së ajrit nga masat më efikase për eliminimin e emetimeve (ndikim i madh pozitiv)
- Kufizimet e ndërtimeve në vendbanimet afër zonave të minierave (ndikim i vogël duke ju qasur këtyre kufizimeve në faza si zbutje)
- Rritjen e të hyrave për qeverinë lokale dhe kombëtare (ndikim i madh pozitiv)
- Rritjen e mundësive të punësimit me zgjerimin e minierave dhe operacioneve të termocentralit (ndikim të vogël pozitiv)
- Rrezikun e inflacionit me mundësi të reja të punës (ndikim i vogël me Strategjinë e Akomodimit në Punët dhe zbutjet e tjera të planifikuara)
- Zhvendosjen fizike të përafërsisht 442 deri 835 personave (siç është theksuar në VNMS 2014), varësisht nga variantet e minierës dhe me ose pa TCKR (duke përfshirë një zonë të sigurisë prej 250 metrash) (negative me planin e zhvendosjes)

- Themelimin e një Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (ndikim i moderuar pozitiv)
- Ndikimi në sigurinë e ushqimit për disa banorë lokal (ndikim i vogël me zbutjen e aplikuar).

37. ÇFARË LLOJE TË MBETJEVE DHE EMETIMEVE DO TË PRODHOHEN GJATË OPERIMIT TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Mbetjet dhe emetimet kryesore përfshijnë emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, zgjyra dhe nën-produktet e mbetjeve të hirit nga prodhimi i energjisë. Secila është përshkruar më poshtë.

Emetimet në ajër. SO_x , NO_x , CO, CO_2 dhe grimcat (PM) në formën e pluhurit janë emetimet më të rëndësishme në ajër nga djegia e linjtit. Gjithashtu emetohen edhe sasi të vogla të materialeve të tjera, si metalet e rënda, grimca benzopirene, klorur hidrogjeni dhe fluorid hidrogjeni, hidrokarbure të padjegura, përbërës organikë të paqëndrueshëm jo-metan dhe në përqendrime shumë të vogla dioksina dhe furani.

Termocentrali i ri do të reduktojë emetimet në atmosferë në krahasim me termocentralet ekzistuese, Kosova B, e sidomos Kosova A, pasi që do të aplikohen teknikat më të mira të mundshme (BAT) në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale të BE-së (IED). TKR i propozuar do të dizajnohet në pajtim me parimet dhe rekomandimet që rezultojnë nga udhëzimet e BE-së për aplikimin e BAT për termocentralet e mëdha me djegie të brendshme.

Shkarkimet e ujërave të zeza. Ujërat e ndotura të mëposhtme vlerësohet se do të prodhohen nga operimi i termocentralit me thëngjill:

- Rrjedhja nga deponia e thëngjillit (reshjet, uji i përdorur për shtypjen e pluhurit)
- Ujërat e ndotura nga trajtimi kimik i ujit (rigjenerimi i shkëmbyesit të joneve)
- Ujërat e ndotura nga sistemi i ftohjes
- Ujërat e ndotura vajore nga dhoma e bojlerit dhe zona e turbinës
- Ujërat e ndotura nga trajtimi i gazrave të tymtarëve (de-sulfurizimi)
- Ujërat nga larja e bojlerit, nga ngrohësi i ajrit dhe të ngjashme
- Ujërat e zeza sanitare
- Ujërat e reshjeve nga sipërfaqet e punës së termocentralit.

Të gjitha rrjedhat e ujërave të ndotura do të kontrollohen dhe lëshohen në mjedis vetëm pas analizimit dhe trajtimit të duhur të ujit që do të lirohet.

Mbeturinat dhe nënproduktet nga prodhimi i energjisë. Zgjyra dhe hiri nga TCKR pritet të transportohen në mënyrë hidraulike në zonën e mihjes të ish-minierës së Mirashit, ku aktualisht ato hidhen. Nivelet përfundimtare të zonës së mbushur do të mbulohen nga materiali i djerrinës dhe pastaj do të ri-kultivohen, duke siguruar rreth 119 hektarë që mund të përdoren për qëllime bujqësore, ndërtim të vendbanimeve turistike dhe/ose qendra rekreative. Gjipsi dhe pjesa e hirit do të përdoren si produkte komerciale (në industri të çimentos dhe të ngjashme).

38. SA CO_2 DO TË EMETOJË TC KOSOVA E RE?

Termocentrali Kosova e Re me kapacitet të instaluar prej 500 MW, me 40% efikasitet neto, për çdo 1 MWh që prodhon do të emetojë 948.1 kg CO_2 në atmosferë.

39. KU DO TË DEPOZITOHEN HIRI DHE NËN-PRODUKTET E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Hiri që mbetet në fund (nga impianti e bojlerit) dhe hiri që lirohet në ajër (nga precipituesit elektrostatik) duhet të transportohen në përputhje me teknikat më të mira të mundshme që nuk shkaktojnë shpenzime të tepërta – sipas

udhëzimeve BATNEEC, nga lokacioni i termocentralit për t'u deponuar në ish-minierat e zbrazura në Bardh dhe Mirash sipas Marrëveshjes për Heqjen e Hirit dhe Gjipsit.

Duhet të theksohet se largimi i hirit dhe gjipsit në ish-minierat e zbrazura në Bardh dhe Mirash do të bëhet në vendet e reja të deponimit të krijuara për deponimin e produkteve nga objekti i TCKR-së. Miniera e Bardhit dhe Mirashit është në pronësi të Divizionit të Mihjes së KEK-ut dhe GenCo do të jetë përgjegjëse për transportimin e hirit deri në vendin e deponimit të tij. Mënyra e deponimit duhet të jetë e tillë që të sigurojë se nuk ka rrezik të përhapjes në mjedisin përreth gjatë jetëgjatësisë së termocentralit, gjithsesi duke përdorur një membranë të padepërtueshme për të mbajtur hirin. Aranzhimet e deponimit të hirit të thatë në lokacionin e termocentralit duhet të jenë të atilla që të zënë hirin e secilës njësi për një periudhë prej 24 orësh të funksionimit të njërive gjatë prodhimit maksimal.

Për shitjen e hirit që lirohet në ajër, rezervuari për deponimin e hirit duhet të konfigurohet për të lejuar ngarkimin përmes gravitetit të mjeteve transportuese me rrota.

Pasi të mbushet një zonë e deponimit të hirit, ajo duhet të mbulohet me argjilë dhe pastaj të rregullohet ambienti sipas tipareve origjinale të ambientit.

Gjipsi i cilësisë që mund të shitet (nëse prodhohet nga procesi i përzgjedhur) duhet të mblidhet nga procesi i desulfurizimit të gazrave të tymtarëve (nëse përzgjidhet teknologjia DQP) dhe transferohet në rezervuarin për deponimin e gjipsit në lokacion, me përmasa për të zënë një minimum të prodhimit 24 orësh të TCKR-së për transport në vendin e deponimit Bardh dhe Mirash, ose potencialisht para se të transportohet për shitje.

Në rast të shitjes së gjipsit, rekomandohet që të ketë depo të përshtatshme në lokacion me një kapacitet prej afro 7 ditësh. Këto mundësi për shitjen e gjipsit do të identifikohen nga ofertuesit e Kontratës EPC & LTM në propozimet e tyre në Fazën 2 të këtij transaksioni.

Gjipsi duhet të hidhet në minierën e zbrazur të Bardhit dhe Mirashit sipas Marrëveshjes për Heqjen e Hirit dhe Gjipsit. Duhet të theksohet se largimi i hirit dhe gjipsit në ish-minierat e zbrazura në Bardh dhe Mirash do të bëhet në vendet e reja të deponimit të krijuara për deponimin e produkteve nga Objekti i TCKR-së.

40. KUSH DO TË JETË PËRGJEGJËS PËR DEKOMISIONIMIN E TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE PASI TË ARRIJË FUNDIN E JETËS OPERACIONALE KOMERCIALE?

Në fund të periudhës 20-vjeçare të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, Termocentrali Kosova e Re do t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës pa asnjë kosto. Qeveria e Kosovës do të ketë mundësi të operojë termocentralin për 20 vjet të tjera para se të kërkohet nxjerrja e termocentralit nga përdorimi. Kostoja e nxjerrjes nga përdorimi do të duhet të bartet nga Qeveria e Kosovës, gjegjësisht operatori i termocentralit.

Si rregull për termocentralet me djegie të linjtit, kostoja e dekomisionimit dhe pastrimi i lokacionit është afërsisht 15% e investimit fillestar ose rreth 150 - 200 milionë euro. Do të jetë praktikë e mirë nëse në vitet e fundit të operimit, operatori i termocentralit fillon me grumbullimin e Fondit të Dekomisionimit në vend që të mbështetet në fonde publike ose donatorë, siç është rasti me dekomisionimin e TC Kosova A.

41. KUSH NË KOSOVË MUND TË SIGUROJË QË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE I PËRMBUSHË STANDARDET E PERFORMANCËS MJEDISORE?

Për ndërtimin dhe funksionimin e Termocentralit Kosova e Re do të nevojitet një numër i lejeve mjedisore, si: Autorizimi Mjedisor, Leja Mjedisore, Leja e Integruar e Mjedisit, Leja e Ujit, Leja e Ndërtimit dhe Leja e Përdorimit.

Të gjitha këto leje shqyrtohen dhe lëshohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). MMPH së bashku me njësitë e saj si Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin për të siguruar pajtueshmërinë e operatorit të pajisur me leje me kushtet dhe me secilën leje.

Shumë kreditorë potencialë në projektin e Termocentralit Kosova e Re janë nënshkrues të Parimeve të Ekuatorit (Equator Principles). Ato sigurojnë një kornizë të përbashkët për standardet mjedisore që duhen miratuar nga industria e financimit të projektit dhe bazohen në udhëzimet e Bankës Botërore dhe të Korporatës Ndërkombëtare Financiare për uljen e ndotjes së sektorit specifik dhe udhëzimet e IFC-së për mjedisin, shëndetin, sigurinë dhe politikat mbrojtëse. GenCo duhet të sigurojë përputhshmërinë me Parimet e Ekuatorit në masën e kërkuar nga kreditori. Parimet e Ekuatorit mund të jenë pjesë përbërëse e Standardeve të Aplikueshme nëse kërkohen nga kreditori.

E. NDIKIMI EKONOMIK

42. SI DO TË NDIKOJË NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE NË QËNDRUESHMËRINË E FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NË KOSOVË?

Për shkak të investimeve të drejtpërdrejta në hapjen e minierës Jugperëndimore të Sibovcit, mirëmbajtjes dhe riparimeve të rregullta të njërive në TC Kosova A dhe TC Kosova B, investimeve në rrjetin e transmissioinit dhe shpërndarjes, rivitalizimin e hidrocentraleve të vogla ekzistuese, ndarjes së sektorit, privatizimit të rrjetit shpërndarës dhe furnizimit, zvogëlimit të humbjeve teknike dhe jo teknike, çmimeve të favorshme në tregun rajonal të energjisë elektrike dhe kuadrit ligjor dhe rregullativ të përmirësuar, furnizimi me energji u stabilizua shumë në krahasim me vitet e para të pas luftës kur ndërprerja e energjisë elektrike, shkarkimet e ngarkesës dhe gjeneratorët e naftës ishin një praktikë shumë e zakonshme.

Edhe me këto investime Kosova mbetet importues neto i energjisë elektrike për rreth 10% të kërkesës së saj dhe përballet me probleme të mëdha në aspektin e sigurimit të kapaciteteve të nevojshme për të mbuluar kërkesën e pikut, sidomos gjatë dimrit dhe në përbushjen e kërkesave të kapaciteteve rezervë të sistemin e energjisë.

Kosova tani përballet me sfida të reja:

- Miniera jugperëndimore e Sibovcit do të shterojë deri në vitin 2024. Si rezultat, duhet të zhvillohet miniera e re. Investimet e nevojshme prej 300 - 500 milionë euro do të duhej të realizohen gjatë 6 vjetëve të ardhshme. Plani i minierës së re që është duke u përgatitur do të jap shifrat e sakta.
- TC Kosova B duhet të përmirësohet për të përbushur Vlerat e Kufizuara të Emetimeve të BE-së, për të përmirësuar efikasitetin dhe për të zgjatur jetën e saj operative deri në vitin 2040. Për të arritur këtë, një studim i fizibilitetit i kryer së fundmi ka ardhur në përfundim se do të duhet të investohen 300 milionë euro në këtë termocentral gjatë periudhës 10 vjeçare.
- TC Kosova A 50 vjet i vjetër duhet të mbyllet pasi nuk është në përputhje me kërkesat mjedisore, është joeficientë dhe jo i qëndrueshëm. Me mbylljen e TC Kosova A, sistemi energjetic i Kosovës do të humbasë rreth 40% të kapacitetit të vet.

Paralelisht, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar skema stimuluese dhe mbështetëse për zhvillimin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE). Disa kapacitete të bazuara në BRE tashmë janë ndërtuar dhe janë në funksion, të tjera janë në ndërtim e sipër, dhe deri në 400 MW janë në faza të ndryshme të procedurës së autorizimit.

Termocentrali Kosova e Re me kapacitet të instaluar prej 500 MW do të ndihmojë Kosovën të plotësojë mungesën e pashmangshme të kapacitetit që do shkaktohet nga mbyllja e TC Kosova A dhe do të sigurojë kohën e mjaftueshme që nevojitet për zhvillimin e të gjitha potencialeve të BRE-ve në Kosovë dhe për zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë në një masë që të kenë ndikim të dukshëm në kërkesën për energji elektrike.

43. A DO TË KRIJOJË MUNDËSI TË REJA PUNËSIMI NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE?

Natyrisht, ndikimi i projekteve të mëdha ndërtimore ndryshon nga një vend në tjetrin, pasi raporti mes kapitalit dhe fuqisë punëtore të angazhuar në çdo projekt të caktuar mund të ndryshojë ndjeshëm, varësisht nga kushtet ekonomike lokale. Megjithatë, një parallogaritje e krijimit të vendeve të punës është se secili miliard i eurove të shpenzuar për ndërtimin e një projekti të madh të infrastrukturës, siç është ndërtimi i këtij termocentrali të ri, e mbështet krijimin e rreth 10,000 vende pune në vit. Këto vende pune janë tri lloje: vendet direkte të punës, vendet indirekte të punës dhe vendet e nxitura të punës. Këto lloje të vendeve të punës do të krijohen gjatë fazës së ndërtimit.

Vendet direkte të punës janë për ata janë njerëz të kualifikuar të punësuar në projekt nga kontraktuesit dhe nënkontraktuesit e EPC-së që paguhen nga financimi i projektit, duke përfshirë çdo financim tjetër lidhur me të.

Vendet indirekte të punës krijohen nga shpenzimet që bëjnë furnizuesit e projektit, për të prodhuar materialet që blihen dhe përdoren për projektin; këto kosto shfaqen në financat e projektit të synuar si pjesë e kostos së materialeve të projektit.

Vendet e nxitura të punës janë vende të punës të krijuara diku tjetër në ekonomi (që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me vet projektin) pasi rritja e të ardhurave nga shpenzimet e drejtpërdrejta të projektit çon në rritje shtesë të shpenzimeve nga kompanitë dhe punonjësit e tyre individualë të përfshirë në projekt.

Pasi të përfundojë ndërtimi i Termocentralit Kosova e Re dhe termocentrali të jetë operacional, numri i njerëzve të punësuar drejtpërdrejt në termocentral do të jetë rreth 500. Gjatë fazës operacionale të termocentralit, vendet më indirekte të punës që ruhen/krijohen janë ato në minierën e linjitet dhe shërbimet mbështetëse të termocentralit. Vendet e tjera indirekte të punës krijohen gjatë kontraktimit të punëve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen dhe riparimet e termocentralit.

44. SI MUND TË PËRFITOJË KOMUNITETI I PREKUR NGA FONDI PËR ZHVILLIMIT TË KOMUNITETIT?

Një përfitim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i projektit të Termocentralit Kosova e Re është krijimi i një Fondit për Zhvillimin e Komunitetit dhe një detyrim financimi i GenCo prej 10 milion Eurosh. Fondi për Zhvillimin e Komunitetit do të disbursohet pas fillimit të ndërtimit për një periudhë 7 vjeçare. GenCo do të kontribuojë në 6 vitet e para me 1.5 milionë Euro në vit, dhe 1 milion Euro në vitin e shtatë.

Fondi për Zhvillimin e Komunitetit do të mbështesë drejtpërdrejtë ata që preken nga projekti. Qëllimi është të ndihmojë komunitetet të përmirësojnë mjediset e tyre sociale dhe fizike, të rris barazinë dhe drejtësinë sociale, të tejkaloj përjashtimin social, të ndërtojnë kapacitetet dhe të përfshijnë komunitetin në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në kushtet e tyre. Fondi është krijuar për të arritur tek përfituesit nëpërmjet programeve të zhvillimit që duhet të projektohen sapo të fillojë ndërtimi. Theksi duhet të vihet në mundësitë për krijimin e vendeve të punës si intervenim i preferuar i nënvizuar nga komuniteti gjatë fazës fillestare të konsultimit.

GenCo do të ketë të drejtën të udhëheqë Panelin e Fondit për Zhvillim e Komunitetit i themeluar nga Marrëveshja e Fondit për Zhvillim të Komunitetit që do të zbatohet para transaksionit të Mbylljes Financiare të Termocentralit Kosova e Re. GenCo dhe Qeveria e Kosovës do të zgjedhin së bashku projektet që do të financohen nga Fondi për Zhvillim të Komunitetit.

45. SI DO TË PËRFITOH EKONOMIA E KOSOVËS NGA TERMOCENTRALI KOSOVA E RE?

Kosova vuan nga mungesa e madhe e energjisë. Sigurimi i një furnizimi të besueshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike është parakusht për mirëqenien sociale dhe aktivitetin ekonomik. Pasja e një burimi të brendshëm të kapaciteteve prodhuese të besueshme dhe stabile gjithashtu kontribuon në krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin e energjisë. Kur kombinohen burimet energjetike që vlejnë për shekuj të tërë me një nga depozitat më të favorshme të minierave të linjitet në botë me termocentralet me teknologjinë më bashkëkohore e cila i përmbush standardet më të rrepta të performancës mjedisore, atëherë krijohen parakushtet për rritjen ekonomike.

Padyshim që kapacitetet prodhuese të bazuara në BRE krijojnë një sektor ekonomik krejtësisht të ri dhe mund të krijojnë qindra vende të reja të punës dhe Kosova është duke ndjekur atë drejtim, është po ashtu i padiskutueshëm fakti që linjitet mbetet shtylla kryesore e stabilitetit ekonomik në vend.

Termocentrali Kosova e Re do të përmirësojë në mënyrë dramatike sigurinë e furnizimit me energji elektrike për dekadat e ardhshme duke lejuar bizneset të rriten – përfshirë ato në prodhimin nga BRE-të, krijojnë parakushte për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në sektorë të tjerë (në TIK, bujqësi, turizëm, minerale) dhe do të ndihmojnë përmirësimin e shëndetit publik përmes zvogëlimit të ndotjes duke zëvendësuar TC e vjetër Kosova A me një termocentral modern.

Studimet kanë treguar se për shkak të mungesës së furnizimit të besueshëm me energji, ekonomia e Kosovës po humb deri në 300 milionë euro në vit dhe nëse ky është problemi i vetëm që Termocentrali Kosova e Re mund të ndihmojë të zgjidhet atëherë nuk ka dyshim për përfitimet e këtij projekti.

Përveç kësaj, mijëra vende të reja të punës do të krijohen gjatë periudhës 4-vjeçare të ndërtimit të termocentralit Kosova e Re dhe mijëra të tjera do të mbahen si rezultat i operacioneve të vazhdueshme të minierave.

Qëllimi i vetëm i Termocentralit Kosova e Re është përmirësimi i sigurisë së furnizimit me energji duke u lënë hapësirë vendimmarrësve dhe sektorit privat që të përqendrohen në përpjekjet për krijimin e vendeve të punës në sektorë të tjerë të ekonomisë.

46. A DO MUND TË PËRBALLOJNË KONSUMATORËT E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË ENERGJINË NGA TERMOCENTRALI KOSOVA E RE?

Kostoja e energjisë elektrike nga Termocentrali i ri Kosova e Re bazohet në metodologjinë e cila do të marrë parasysh kostot aktuale të nevojshme për zhvillimin e Termocentralit Kosova e Re. Të gjitha këto kosto do të dihen saktësisht në Datën e Mbylljes Financiare.

Njësitë përbërëse të çmimit të energjisë elektrike nga Termocentrali Kosova e Re janë:

- Kostoja e Kapitalit
 - Kostoja e Kapitalit dihet pasi që ka qenë parametër i ofertës që është negociuar (Faza 1)
 - Kostoja e Borxhit aktualisht nuk dihet pasi që borxhi duhet të caktohet (Faza II)
- Kostoja e Zhvillimit
 - Kostoja e Zhvillimit dihet pasi që ka qenë parametër i ofertës që është negociuar (Faza 1)
- Kostoja e Kontraktuesit Inxhinierim-Prokurim-Ndërtim (EPC)
 - Kostoja EPC do të dihet kur të vije koha për dorëzimin e ofertave për Kontratën EPC dhe LTM (Faza II). Kjo kosto do të jetë rezultat i një procesi konkurrues ndërkombëtar.
- Kostot Operacionale
 - Kostot operacionale kryesisht dihen (puna, linjiti, uji, kimikatet, shërbimet)
 - Kostoja e Mirëmbajtjes kryesisht dihet, por do të përfshijë inputet nga Kontraktuesi i EPC-së dhe LTM (Faza II). Kjo kosto do të jetë rezultat i një procesi konkurrues ndërkombëtar.
- Kostot e tjera që nuk janë nën kontrollin e GenCo
 - Ndryshimi i ligjit (taksa, tantimat, ...), ndryshimi i çmimit të linjitit si rezultat i investimeve për zhvillimin e minierës së re etj.

Meqenëse një numër i shpenzimeve nuk janë përcaktuar aktualisht, por ato mund të supozohen nga zhvilluesit me përvojë dhe këshilltarët e transaksionit, GenCo do të marrë përsipër një rrezik të caktuar, p.sh. rrezikun e kostonë së ndërtimit. Si rezultat, çmimi i energjisë elektrike në MBE-së është kufizuar në 80 Euro/MWh. Për qëllime ilustruese: nëse çmimi i EPC-së është më i ulët do të reflektohet në një çmim më të ulët të energjisë elektrike; nëse çmimi i EPC-së është më i lartë çmimi nuk do të shkojë mbi 80 Euro/MWh.

Vlen të theksohet se edhe nëse Qeveria e Kosovës ose KEK-u do të donin të ndërtonin një njësi të re ata do të kishin këto paqartësi derisa të bëheshin ofertat për EPC-në.

Gjatë vlerësimit të këtij projekti, duhet të kuptohet se Termocentrali Kosova e Re do t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës në fund të periudhës 20-vjeçare të MBE-së. Pas kësaj Kosova do të vazhdojë të përfitojë nga ky impiant edhe për 20 vjet të tjera me kosto shumë më të ulët të energjisë elektrike sesa çmimi i MBE-së, pasi objekti do të amortizoj financimin e tij. Kjo është po ashtu arsyeja pse tani përfitojmë nga energjia me kosto të ulët nga TC Kosova A dhe TC Kosova B.

Konsumatorët e energjisë elektrike do të paguajnë një çmim real të tregut për të pasur burime të besueshme dhe të sigurta të energjisë vendore. Alternativa është varësia nga energjia e importuar dhe parashikimet e pasigurta afatgjata të çmimit të energjisë elektrike.

Ruajtja dhe krijimi i vendeve të reja të punës janë elementë me ndikim në vendimet e përcaktimit të këtyre politikave.

47. A E PENGOJNË NDËRTIMI DHE MARRËVESHJET KONTRAKTUESE TË TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS?

Qeveria e Kosovës ka pranuar nevojën për një marrëveshje afatgjatë për blerjen e energjisë si zgjidhje të vetme të përballeshme financiarisht për Kosovën për të tërhequr investimet e sektorit privat që janë të nevojshme për të adresuar shqetësimet afatgjata mjedisore të sigurisë së furnizimit të pranishme në vend.

Kohëzgjatja e marrëveshjes së blerjes së energjisë elektrike është mjaftueshëm e gjatë për të lejuar amortizimin e financimit, duke e mbajtur çmimin në nivel të arsyeshëm për një impiant të ri të ndërtuar. Çdo kohëzgjatje më e shkurtër e marrëveshjes së blerjes së energjisë në kohën kur kërkohen investime të njëkohshme në TC Kosova B dhe në zhvillimin e minierës do të rezultonte me tarifa të energjisë elektrike të papërballeshme për shumicën e kategorive të konsumatorëve.

Prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës është rikthimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike, ndërsa në të njëjtën kohë bën përpjekje për të liberalizuar pjesën e furnizimit me energji elektrike brenda realitetit ku ekziston marrëveshja afatgjatë e blerjes së energjisë për të adresuar sigurinë e furnizimit në vend.

Është vërejtur se tregu rajonal të energjisë elektrike do t'i duhet pak kohë për t'u zhvilluar në nivelin ku do të ketë suficit të prodhimit dhe tregu rajonal do të ofrojë parashikueshmëri të caktuar të çmimeve të importit. Shumica e kapaciteteve të reja prodhuese termike në rajon bazohen në marrëveshje afatgjatë të blerjes së energjisë ose disa lloj të garancie qeveritare të blerjes, pasi kjo është mënyra e vetme e mundshme për financimin e këtyre projekteve. E njëjta situatë është edhe me kapacitetet e reja të BRE-ve, do të jetë e vështirë, nëse jo e pamundur, për të pasur ndonjë investitor privat për të financuar një kapacitet të ri BRE-ve, pa skemën e mbështetjes (blerje e garantuar për një kohë të gjatë me tarifa nxitëse).

Vizioni afatgjatë i Kosovës është për liberalizimin e plotë të tregut si të prodhimit ashtu edhe furnizimit dhe si hap i parë është krijimi i shkëmbimit të përbashkët të energjisë midis Kosovës dhe Shqipërisë.

48. SI DO TË NDIKOJË TERMOCENTRALI KOSOVA E RE NË TREGUN E PËRBASHKËT KOSOVË-SHQIPËRI?

Parimi bazë i bashkimit të tregut në Kosovë-Shqipëri është që të dyja sistemet e energjisë kërkojnë të përfitojnë reciprokisht nga asetet krejtësisht të ndryshme prodhuese: kapacitetet e hidrocentraleve në Shqipëri dhe termocentralet në Kosovë.

Me kapacitete të mjaftueshme termike, Kosova mund të kontribuojë me energji të qëndrueshme bazuar në burime të bollshme të linjtit. Aktualisht, Kosova nuk ka kapacitete të tilla dhe është e detyruar të fillojë planifikimin e nxjerrjes nga përdorimi i TC Kosova A, duke humbur pothuaj gjysmën e kapaciteteve prodhuese ekzistuese. Me ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re, Kosova do të jetë në gjendje të sigurojë disa sasi të caktuara për të mbuluar kërkesën e ngarkesës bazë të këtyre dy sistemeve të energjisë, duke përfituar nga energjia e pikut dhe rezervat e sistemit nga Shqipëria kur TC Kosova B, Termocentrali Kosova e Re dhe BRE-të nuk do të jenë në gjendje të plotësojnë kërkesën.

Vlen të përmendet se kapaciteti maksimal i TC Kosova B dhe Termocentralit Kosova e Re do të jetë midis 980 - 1050 MW, me 400 MW shtesë të prodhuara nga BRE-të, kur ato të bëhen operacionale dhe me kusht që të jenë në dispozicion.

Disponueshmëria e Termocentralit Kosova e Re në tregun e përbashkët Kosovë-Shqipëri do të jetë shumë e dobishme gjatë periudhave pa rreshje kur çmimet rajonale të importit janë në nivelin më të lartë, kështu që Termocentrali Kosova e Re do të sigurojë furnizim të sigurt për Kosovën dhe Shqipërinë.



QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

TEL: 038 200 215 83
WWW.MZHE-KS.NET